# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7158
E premte, 5 prill 2024
Çmimi 0. 50


## Kosova dhe Serbia, pa marrëveshje për dinarin në Bruksel

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# KONFISKOHEN TRI PRONA TË RADOIÇIQIT NË KOSOVË

FAQE 4



Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka konfiskuar të enjten dy prona të paluajtshme në Mitrovicën e Veriut dhe një në komunën e Zubin Potokut, në pronësi të Milan Radoiçiqit. "Ka pasur një urdhër gjykate për konfiskimin e tri pronave, vilës së Milan Radoiçiqit, restorantit 'Grey' dhe një banese në katin e gjashtë mbi restorantin 'Grey'", ka thënë zëvendësdrejtori i policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani

## KRERËT E SHTETIT E KUJTOJNË BETEJËN E KOSHARES

F. 8



## 50 EURO GJOBË PËR KËMBËSORËT TË CILËT KALOJNË RRUGËN ME TELEFON NË DORË APO DËGJUESE NË VESH



## AKTUALE



### NDIHMA AMERIKANE PËR UKRAINËN MUND TË MARRË FORMË SË SHPEJTI, POR SI?

F. 2

### OSMANI E PEACH DISKUTOJNË PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

F. 3

### HARADINAJ, KRITIKA PËR VIZITËN E KURTIT NË VERI

F. 3

### THEMELOHET KOMISIONI HETIMOR PARLAMENTAR PËR SUBVENCIONIMIN E TEKSTEVE DHE MJETEVE SHKOLLORE

F. 5

## EKONOMI



### NË BE ARRIHET MARRËVESHJE PËR PLANIN 6 MILIARDËSH PËR RRITJE EKONOMIKE NË BALLKAN

F. 7

## SPORT



### MKRS-JA NDAN 9 MILIONË EURO PËR RENOVIMIN E STADIUMIT NË GJAKOVË

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Ndihma amerikane për Ukrainën mund të marrë formë së shpejti, por si?

Kiev, 4 prill - Pas vonesave disamujore që ia kanë plogështuar forcën luftarake Ukrainës kundër pushtuesit rus, një projektligj miliarda dollarësh shumë shpejt mund të miratohet nga Kongresi amerikan, megjithëse me shumë ndryshime.

Mike Johnson, kryetar republikan i Dhomës së Përfaqësuesve, tha më 31 mars për "FoxNews" se dëshiron që ndihma e re për Ukrainën të aprovohet "menjëherë" dhe la të kuptohej se do ta paraqesë një paketë së shpejti, sapo të kthehet Kongresi nga pushimi më 9 prill.

Johnson tha se propozimi i tij do të përfshinte "inovacione të rëndësishme", duke lënë të kuptohet se ai do të dallojë shumë nga projektligji që u miratua nga Senati në shkurt, pas shumë muaj mospajtimesh e refuzimesh nga republikanët për paketën që presidenti Joe Biden e kërkoi në tetor.

Projektligji i miratuar nga Senati autorizon rreth 60 miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën, kryesisht për armatim dhe ndihma të tjera ushtarake.

Johnson nuk i përshkroi në hollësi planet e versionit të paketës së tij, por la të kuptohej se ligjvënësit do t'i shqyrtonin së paku tri elemente të mundshme: dhënien e ndihmës në formë të huas; përdorimin e aseteve të ngrira ruse për ta mbështetur Ukrainën; dhe rritjen e eksporteve të gazit natyror amerikan për t'ia kufizuar Rusisë të hyrat.

Një grup i zëshëm i republikanëve të krahut të djathtë në Dhomën e Përfaqësuesve ka ngritur shqetësime për ndihmën për Ukrainën, mbështetjen e saj financiarisht në veçanti, duke theksuar reputacionin e kamotshëm të këtij vendi për korrupsion. Ata, gjithashtu, thonë se është më mirë që ato para të shpenzohen në shtëpi.

Ish-presidenti Donald Trump, kandidat i supozuar i Partisë Republikane për t'u përballur me Bidenin në zgjedhjet e nëntorit, ka shprehur ngurrimin e tij për ta ndihmuar Ukrainën, por ka thënë se do t'i mbështeste huat për të, një ide të cilën Johnsoni e ka shfrytëzuar. "Madje edhe presidenti Trump ka folur për konceptin e huave, ku... ne nuk japim ndihmë për të huajt, por ne e ofrojmë atë në një marrëdhënie sipas së cilës ata na e kthejnë atë në kohën e duhur", tha Johnsoni.

Ai nuk theksoi nëse të gjitha ndihmat në projektligj janë borxh që duhet të kthehet, apo vetëm mbështetja financiare, edhe pse disa ekspertë thonë se, me gjasë, vetëm kjo e fundit.

Senatori Mitt Romney, një republikan i cili e mbështeti projektligjin e Senatit, e quajti idenë e huazimit të parave Ukrainës "turpërim", duke thënë se Kievi nuk do të jetë në gjendje ta paguajë një borxh të tillë për shkak të shkatërrimit të vendit nga lufta.

Disa në Shtetet e Bashkuara duan që ta detyrojnë Rusinë ta financojë rindërtimin e Ukrainës duke ia konfiskuar rezervat e Bankës



Qendrore, të cilat po mbahen nga Perëndimi dhe duke i përdorur ato për ta mbështetur Kievin, një vendim kundërthënës, i cili mund ta minojë besimin në dollarin amerikan, sipas ekspertëve.

Senatorët e miratuan vitin e kaluar Aktin për Rindërtim, Prosperitet Ekonomik dhe Mundësi për Ukrainasit, i cili do t'i jepte autoritet presidentit amerikan t'i konfiskonte asetet dhe t'i transferonte ato në Ukrainë.

Megjithatë, shumica e rezervave ruse mbahen në Bashkimin Evropian, gjë që kërkon përfshirjen e Brukselit. BE-ja është duke e studiuar idenë e konfiskimit të aseteve ruse në vlerë rreth 300 miliardë dollarë.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian po kërkojnë ta minojnë aftësinë e Rusisë për ta financuar luftën e vet në Ukrainë, duke ia sanksionuar eksportet e energjisë, përmes të cilave ajo gjeneron mbi 30 për qind të të hyrave të buxhetit federal.

ShBA-ja, prodhuesi më i madh në botë i gazit natyror, ka resurse për të eksportuar sasi më të mëdha të gazit të lëngshëm natyror (GLN) dhe kështu ta kufizojë fitimin e Rusisë në treg. Megjithatë, ajo nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme për ta bërë këtë.

Johnson tha për "FoxNews" se dëshiron të këtë "eksportim të gazit natyror, i cili do të ndihmojë në bllokimin e financimit të luftës së Vladimir Putinit".

Plani i Johnsonit për ta paraqitur një projektligj, i cili ka mundësi të dallojë shumë nga projektligji i Senatit, ka shkaktuar shqetësime në mesin e mbështetësve të Ukrainës në të dyja anët e spektrit politik në Dhomën e Lartë të Kongresit.

Senatorja nga Kalifornia, Laphonza Bulter, nga radhët e demokratëve, tha se ndryshimet e mundshme në projektligjin për Ukrainën mund ta nxisin një debat të gjatë, duke paralajmëruar se koha nuk është në anën e Ukrainës.

Senatori Sheldon Whitehouse, nga radhët e demokratëve, tha se ai i pranon ndryshimet e mundshme. "Jam i kënaqur që ndihma për Ukrainën do të bëhet", tha ai.

Mitch McConnel, i cili është lider i republikanëve në Senat, është shprehur i zemëruar me planin e Johnsonit për ta paraqitur projektligjin e vet, duke thënë se "po na ikën koha".

# Bullgaria gjen armë që dyshohet se janë të lidhura me Hamasin



Sofje, 4 prill - Policia bullgare ka gjetur armë të lidhura me katër persona që dyshohet se janë anëtarë të Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Ata ishin arrestuar në Gjermani dhe Holandë dhjetorin e vitit të kaluar, sipas raportimeve të medieve gjermane dhe AFP-së.

Tre anëtarë të dyshuar të grupit radikal palestinez ishin arrestuar në Gjermani më 14 dhjetor, nën dyshimet se po përgatisnin të kryenin një sulm kundër caqeve hebraike në Evropë.

I dyshuari i katërt u arrestua në Holandë.

Prokurorët gjermanë thanë se katër personat po mblidhnin armë dhe "po i mbanin gati për kryerjen e sulmeve të mundshme terroriste kundër institucioneve hebraike në Evropë".

Revista "Der Spiegel" raportoi se policia gjeti fotografi të pistoletave e municioneve në telefonin e një prej të arrestuarave. Këto fotografi çuan hetuesit deri te gjetja e armëve që ishin groposur poshtë një pishe në jug të Bullgarisë, raportoi kjo media gjermane.

Prokurorët bullgarë dhe Ministria e Brendshme kanë refuzuar të konfirmojnë këto raportime.

## SPAK-u: Nuk mund ta luftojmë të vetëm korrupsionin

Tiranë, 4 prill - Institucionet në Shqipëri, me përjashtim të policisë, nuk referojnë rastet korruptive pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK). Këtë shqetësim e përcolli kreu i SPAK-ut, Altin Dumani, gjatë raportimit për punën e institucionit që drejton pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

"Përjashtuar policinë e shtetit, institucione të tjera që kanë pjesë të detyrave e kompetencave të tyre dhe luftën kundër korrupsionit, qoftë të nivelit qendror apo lokal. nuk referojnë në SPAK veprat penale të natyrës korruptive apo vepra të tjera penale. Ky është shqetësim për SPAK-un, pasi SPAK-u i vetëm nuk mund të adresojë dhe përballojë luftën kundër korrupsionit", tha Dumani.

Ai tha se referimi nga këto institucione ka një tendencë të fortë rënieje, që shkon deri në 40 për qind krahasuar me vitin 2022, ndërsa SPAK-u i ka rritur procedimet e reja penale me 16 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë.

Edhe pse e konsideroi shumë të mirë bashkëpunimin me policinë, Dumani tha se disa dosje nuk mund t'i hetojnë së bashku.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Haradinaj, kritika për vizitën e Kurtit në veri

PRISHTINË, 4 PRILL - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti po mundohet t'i mbulojë lëshimet që po i bën. Teksa komentoi vizitën e Kurtit në veri, ai theksoi se shefi i ekzekutivit po tenton ta mashtrojë kryetarin e Leposaviqit, Lulzim Hetemi. "Kryeministri Kurti po mundohet të mbulojë disa lëshime që po i bën, për t'u arsyetuar kryesisht te votuesit e tij. Ishte rasti i tokave për Manastirin e Deçanit e tani janë lëshimet e tjera si letra e tre udhëheqësve institucionalë, ishte pastër marrja e obligimit për zbatim të asociacionit, njëkohësisht edhe zbatimi i peticionit. Pra aty ku ka shkuar Kurti, ai po paguan para për të shkarkuar atë. Ka shkuar ta mashtrojë edhe Lulzim Hetemin për t'i thënë është patriotike për të shkarkuar me peticion përmes serbëve", ka thënë Haradinaj.

Para medieve, Haradinaj ka theksuar se roli i presidentes Vjosa Osmani është inekzistent. Kështu u shpreh ai teksa u pyet për trevjetorin e zgjedhjes së presidentes së shtetit. "Inekzistente, ne kemi një pushtet, është Kurti, të gjithë të tjerët janë staf i tij", është shprehur lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.



# Osmani dhe Peach diskutojnë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës



PRISHTINË, 4 PRILL - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim të dërguarin e posaçëm të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lordin Stuart Peach.

Në takim u diskutua për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, zhvillimet e fundit në vend dhe rajon, si dhe mbi sfidat e sigurisë në rajon dhe përtej.

Në temën e Këshillit të Evropës, presidentja Osmani theksoi se anëtarësimi i Kosovës do të ishte triumf për demokracinë dhe për të drejtat e njeriut jo vetëm në Kosovë, por në mbarë Evropën.

Tutje, presidentja Osmani ritheksoi se përmes mekanizmave të ndryshëm që i ofron Këshilli do të mundësohej mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen dhe ritheksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar në këtë drejtim, sikurse në çdo proces tjetër të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Në takim u diskutua edhe për situatën e sigurisë, me theks të veçantë në veriun e vendit.

## Vuçiqi kërkon formimin e një ekipi kundër anëtarësimit të Kosovës në Këshill të Evropës

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka bërë thirrje të enjten, gjatë një takimi të jashtëzakonshme të qeverisë serbe, për formimin e një ekipi për ta kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Në takimin në Beograd, ku mori pjesë edhe kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Ana Bërnabiq, Vuçiqi u kërkoi të pranishmëve të luftojnë më shumë në politikën e jashtme përmes bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë, Parlamentit dhe Presidencës. "Ne kemi detyra të vështira dhe të rëndësishme, dhe do të kërkoja nga të gjithë anëtarët e qeverisë, pavarësisht se çfarë funksionesh do të kryejnë pas formimit të qeverisë së re, të punojnë me përkushtim për kryerjen e këtyre detyrave", tha Vuçiqi.

Vuçiqi tha se janë disa "gjëra të rëndësishme" për të cilat duhet të pajtohen, pa marrë parasysh se brenda një kohe të shkurtër do të formohet Qeveria e re e Serbisë. Ai tha se Serbia përballet me sfida të vështira, duke përmendur dialogun me Kosovën, si dhe mundësinë e pranimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Ai kërkoi nga Qeveria ta formojë një ekip dhe t'ua dërgojë të gjithëve një dokument joformal, në të cilin do të paraqitet qëndrimi i Serbisë për anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në Këshillin e Evropës.

## 50 euro gjobë për këmbësorët të cilët kalojnë rrugën me telefon në dorë apo dëgjuese në vesh

PRISHTINË, 4 PRILL - Policia e Kosovës ka treguar se cilat janë gjobat për shoferët të cilën përdorin telefonat sa janë duke lëvizur me vetura në trafikun rrugor dhe për këmbësorët të cilët përdorin telefonin dhe mbajnë dëgjuese në veshë sa janë duke kaluar rrugën apo shiritin për biçikleta.

Policia e Kosovës përmes një postimi në rrjetin social në "Facebook" ka shkruar se shoferit të mjetit me veprim motorik gjatë kohës së drejtimit i ndalohet mbajtja e telefonit të dorës dhe pajisjeve të tjera të cilat do ta zvogëlonin mundësinë e reagimit dhe drejtimit të sigurt të mjetit.

Sipas tyre, mosrespektimi i kësaj rregulle ndëshkohet me masë dhe gjobë.

"Një pikë negative dhe gjobë prej 100 eurosh, kur vepron për herë të parë në shkelje të rregullit, dy pikë negative, një muaj ndalesë në drejtim të mjetit motorik dhe 200 euro gjobë kur vepron për herë të dytë, tri pikë negative, gjashtë muaj ndalesë në drejtim të mjetit motorik dhe 500 euro gjobë kur vepron për herë të tretë", thuhet në njoftim.

Policia përmes njoftimit ka bërë me dije se edhe këmbësorëve iu ndalohet përdorimi i telefonit dhe dëgjuesve në veshë gjatë kalimit të rrugës, të shiritit, të shtegut të biçikletave ose të binarëve. "Këmbësorë: Gjatë kalimit të rrugës, të shiritit apo të shtegut të biçikletave ose të binarëve, këmbësorit nuk i lejohet përdorimi i telefonit mobil, shfrytëzimi i dëgjueseve në veshë apo i pajisjeve të tjera të ngjashme që mund ta hutojnë. Mosrespektimi i kësaj rregulle ndëshkohet me gjobë (50) euro, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij rregulli. Mos përdor telefonin dhe mjete të tjera hutuese përderisa jeni pjesë e trafikut! Mos rrezikoni jetën tuaj dhe të të tjerëve", thuhet në njoftim.



# Konfiskohen tri prona të Radoiçiqit në Kosovë

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka konfiskuar të enjten dy prona të paluajtshme në Mitrovicën e Veriut dhe një në komunën e Zubin Potokut në pronësi të Milan Radoiçiqit. “Ka pasur një urdhër gjykate për konfiskimin e tri pronave, vilës së Milan Radoiçiqit, restorantit ‘Grey’ dhe një banese në katin e gjashtë mbi restorantin ‘Grey’”, ka thënë zëvendësdrejtori i policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani



**Prishtinë, 4 prill** - Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka konfiskuar të enjten dy prona të paluajtshme në Mitrovicën e Veriut dhe një në komunën e Zubin Potokut, të cilat janë të lidhura me sulmin e një grupi të armatosur serbësh ndaj policisë së Kosovës në Banjskë shtatorin e vitit të kaluar.

Lajmi u konfirmua për “Radion Evropa e Lirë” nga Veton Elshani, zëvendësdrejtor i policisë për rajonin e veriut. Ai tha se policia ndihmoi këtë agjenci, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë të Kosovë. “Ka pasur një urdhër gjykate për konfiskimin e tre pronave, vilës së Milan Radoiçiqit, restorantit ‘Grey’ dhe një banese në katin e gjashtë mbi restorantin ‘Grey’”, tha Elshani.

Vila gjendet buzë liqenit të Ujmanit në komunën e Zubin Potokut në veri të Kosovës, ndërsa restoranti dhe banesa gjenden në Mitrovicë të Veriut - komuna të banuara me shumicë serbe.

Këto tri prona të paluajtshme ishin sekuestruar fillimisht nga Prokuroria e Kosovës në shtatorin e vitit të kaluar.

Millan Radoiçiq, ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë, ka pranuar se ka organizuar dhe udhëhequr sulmin ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator, ku mbeti i vrarë një polic, ndërsa gjatë shkëmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues.

Kosova ka akuzuar Serbinë se qëndron pas sulmit në Banjskë, por Beogradi ka thënë se nuk ka gisht në të.

Lista Serbe, partia që gëzon mbështetjen e Beogradit, deklaroi se konfiskimi i pasurisë së Millan Radoiqit është i paligjshëm dhe i pabazuar dhe se synon “përshkallëzimin” dhe “largimin e serbëve nga Kosova”.

Ky është reagimi i parë i Listës Serbe për ngjarjet në lidhje me Millan Radoiçiqin pas sulmit në Banjskë.

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, paraprakisht deklaroi se u bashkohet thirrjeve të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se rasti duhet të trajtohet urgjentisht nga institucionet kompetente të Banjskës.

Në Kosovë ende nuk është ngritur ndonjë aktakuzë ndaj Radoiçiqit, ndonëse është paralajmëruar se do të ngrihet deri në fund të marsit të këtij viti.

Në dhjetor të vitit të kaluar Agjencia Ndërkombëtare e Policisë (INTERPOL) kishte lëshuar një fletarrestim për Radoiçiqin me kërkesë të Kosovës, i cili iu dërgua përmes Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Supozohet se Radoiçiqi ndodhet në Serbi.

Radoiçiqi u paraqit para Gjykatës së Lartë në Beograd tetorin e vitit të kaluar, por gjykata hodhi poshtë propozimin e Prokurorisë së Lartë Publike për ta caktuar masën e paraburgimit. Atij i është shqiptuar masa e ndalimit të daljes nga territori i Republikës së Serbisë si dhe e ndalimit për të shkuar në Kosovë.

Komuniteti ndërkombëtar ka bërë thirrje disa herë që përgjegjësit për sulmin në Banjskë të përballen me drejtësinë.

# Themelohet Komisioni Hetimor Parlamentar për subvencionimin e teksteve dhe mjeteve shkollore

**Prishtinë, 4 prill** - Me 61 vota për dhe 4 kundër, Kuvendi i Kosovës ka themeluar Komisionin Hetimor Parlamentar për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e nivelit të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët për vitin shkollor 2023/2024.

Kjo temë solli përplasje në Kuvend gjatë ditës në mes të deputetëve të opozitës, pozitës dhe ministrave të qeverisë.

Opozita akuzoi ministren e Arsimit, Arbërie Nagvaci, për keqpërdorime dhe manipulime, gjatë procesit të subvencionit të teksteve dhe mjeteve shkollore.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Ardian Kastrati, në seancën plenare të së enjtes në Kuvend, ka akuzuar ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci, për krim të organizuar në procesin e subvencionimit të teksteve shkollore.



Kastrati i ka akuzuar Mihalin dhe Nagavcin për “krim të organizuar” në procesin e subvencionimit të teksteve shkollore. “Kjo është logoja e Albasit. Këtu në librin Aventurat e Verës është autore Arbërie Nagavci. Pra, Albasi e ka paguar këtë”, ka deklaruar Kastrati.

Ai ka akuzuar qeverinë për shkeljen e ligjit për ndarjen buxhetore, duke thënë se ka pasur manipulime për tekstet shkollore në favor të një shtëpie botuese.

Nga ana tjetër, ministrja e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci. tha se mezi presin për themelimin e këtij komisioni, sipas saj, për të hetuar t’i gjitha keqpërdorimet që e kanë ndodhur ndër vite kur partitë e tjera kanë udhëhequr Ministrinë e Arsimit. “Ndonëse kërkesa e PDK-së për themelimin e këtij komisioni hetimor parlamentar është e bazuar krejtësisht në të pavërteta dhe në pasaktësi, unë personalisht, gjithë kabineti im dhe të gjithë kolegët në ministri, mezi presim themelimin e këtij komisioni dhe të flasim për këtë temë sepse po, duhet hetuar të gjitha abuzimet për keqpërdorime që kanë ndodhur ndër vite, në kohën kur PDK-ja udhëhiqte Ministrinë e Arsimit. Por, jo vetëm PDK-ja. Në arsyetimin tuaj në kërkesën që e keni dërguar për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar ju keni thënë se kemi dështuar në furnizimin me tekste shkollore për nxënësit. Kjo është e pavërtetë. Ne nuk kemi asnjë raport, asnjë kërkesë, asnjë ankesë nga asnjë drejtori e arsimit e cila thotë se nuk janë furnizuar fëmijët apo se kanë mungesë të teksteve mësimore”, ka thënë Nagavci.

# Regjistrimi i dëmeve gjatë luftës: Sa reale mund të jenë ato?


Bujar Tërstena (RFE/RL)

PRISHTINË, 4 PRILL - Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, i cili do të zhvillohet në Kosovë nga data 5 prill deri më 17 maj, do t'u mundësojë qytetarëve të deklarohen, mes të tjerash, edhe për dëmet që u ka shkaktuar lufta gjatë viteve 1998/1999.

Në mesin e pyetësorëve, me të cilët do të shërbehet Agjencia e Statistikave të Kosovës gjatë procesit të regjistrimit, është edhe ai për dëmet nga lufta në ekonomitë familjare.

Të dhënat që do të mblidhen në këtë kontekst do të shërbejnë vetëm si kornizë orientuese për institucionet e Kosovës, thotë ushtruesi i detyrës së drejtorit të ASK-së, Avni Kastrati.

Këto të dhëna, sipas tij, do t'u shërbejnë institucioneve të Kosovës për t'i identifikuar më lehtë rastet e krimeve dhe dëmeve të luftës. "Kjo është vetëm një kornizë, një plotësim i burimeve të tjera që ka Kosova, organizatat dhe institucionet e saj. Kjo nuk nënkupton që ne dalim nesër me një raport dhe themi se 'janë kaq dëme'", thotë Kastrati për Radion Evropa e Lirë.

Përveç për dëmet në njerëz, pyetësori i ASK-së synon të marrë përgjigje nga qytetarët edhe për pronat e shkatërruara, duke i kategorizuar ato sipas vlerës monetare nga 10 mijë euro deri në mbi 40 mijë euro.

ASK-ja, më pas, do të krijojë një databazë me të dhënat për dëmet nga lufta, të deklaruara nga qytetarët. Kjo databazë do t'i dorëzohet Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, konfirmon drejtori i këtij instituti, Atdhe Hetemi.

Informatat që do të nxirren nga databaza e krijuar nga ASK-ja, sipas tij, do t'i shërbejnë institutit për analiza krahasuese me informacionet që tashmë ekzistojnë lidhur me krimet e luftës dhe dëmet në prona. "Së dyti, na shërbejnë për të bërë një lloj harte, se në cilat zona të Kosovës ka pasur më shumë dëme apo krime, në mënyrë që ne, më pas, në momentin që fillojmë punën për mbledhjen e dokumenteve që dëshmojnë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, ta dimë se kah të fokusohemi", thotë Hetemi.

Dokumentimi i krimeve të luftës në Kosovë është konsideruar si urgjencë nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, për shkak se "me kalimin e viteve jemi duke i humbur dëshmitarët".

Të martën ai ka thënë se në kuadër të procesit të regjistrimit të popullsisë, pyetësori do t'u mundësojë qytetarëve të dëshmojnë për pronat e shkatërruara, për dëmet në familjarë, qofshin ata të vrarë, të plagosur apo të zhdukur në periudhën nga 28 shkurti 1998 deri më 12 qershor 1999.

## Sa të sakta mund të jenë të dhënat për shkatërrimin e pronave?

Kastrati thekson se të dhënat që mund të mblidhen nga deklarimi i qytetarëve mund të mos jenë reale. Por, sipas tij, ASK-ja nuk e ka për detyrë ta verifikojë saktësinë e këtyre të dhënave. Kjo detyrë, sipas tij, u takon komisioneve ose agjencive të tjera të Qeverisë së Kosovës. "Komisioni pastaj del dhe i verifikon. Kanë punë... Do të marrë vite kjo, s'e besoj që e kanë lehtë", thotë Kastrati.

Hetemi thotë, po ashtu, se autoritetet janë të vetëdijshme që mund të ketë deklarime të pasakta ose eventualisht të rrejshme nga qytetarët për shumat e caktuara që janë vendosur në pyetësor lidhur me pronën e shkatërruar.

Sipas tij, të dhënat për dëmet nga lufta, të deklaruara nga qytetarët, nuk do të konsiderohen me automatizëm si të mirëqena, për t'i futur në arkiv të institutit.

Ato, siç thotë ai, do t'i nënshtrohen një lloj procesi të hulumtimit për verifikim të saktësisë së tyre. Këtë hulumtim, sipas tij, do ta bëjë instituti që ai drejton. "Instituti nuk është institucion hetues, por institucion hulumtues. Nëse ka verifikim gjyqësor apo ligjor, atë mbase e bëjnë institucionet e tjera, por jo ne. Ne i verifikojmë deri në atë masë sa na duhet për të vendosur se a mund t'i vendosim në arkivat tona dhe a mund t'i përdorim për qëllime të hulumtimit ose jo", thotë Hetemi.

Muaj më parë, në prag të themelimit të Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës, kryeministri Kurti deklaroi se "Kosova ende nuk e di dëmin ekonomik, emocional dhe psikologjik që ia ka shkaktuar lufta e fundit".

## Arifi: Padia në GjND, aktualisht e pamundur

Më 30 mars Kurti tha se autoritetet e Kosovës po përgatiten që Serbia të akuzohet si shtet përgjegjës "për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, e që janë krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid".

Deklarata e Kurtit u cilësua kërcënuese nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Ai tha se Kurti tani do që t'i përdorë institucionet e Këshillit të Evropës për të iniciuar padi ndaj Serbisë.

Vuçiqi i bëri këto deklarata tri ditë pasi Kosova bëri një hap më afër anëtarësimit në Këshillin e Evropës.

Dritëro Arifi, profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Kolegjin UBT në Prishtinë, thotë se institucionet e Kosovës duhet t'i mbledhin të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe të jenë të gatshme për një padi ndaj Serbisë për krime lufte dhe gjenocid në Kosovë. Por, siç thotë ai, Kosova aktualisht nuk mund të ngrejë padi për gjenocid ndaj Serbisë.

Padia për gjenocid, sipas tij, ngrihet në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila ka selinë në Hagë. Të drejtën e ngritjes së padisë së tillë e kanë vetëm shtetet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, pjesë e së cilës Kosova nuk është ende.

Megjithatë, siç thotë Arifi, padi ndaj shtetit të Serbisë mund të ngrehin qytetarët e Kosovës, në mënyrë individuale - qoftë për dëmin njerëzor, shpirtëror dhe material, vetëm pasi t'i kenë shteruar mundësitë ligjore në gjykatat vendore në Kosovë. "Nëse personi është i pakënaqur me vendimin e gjykatave vendore të të gjitha shkallëve, atëherë mund t'i drejtohet Gjykatës në Strasburg për të drejtat e njeriut", thotë Arifi.

Ai shton se rastet e tilla eventuale do të ishin të vështira, pasi proceset e tilla marrin shumë vjet kohë.

Arifi thekson se në rast se Kosova anëtarësohet në Këshillin e Evropës, atëherë ajo mund ta iniciojë kërkesën për miratimin e një rezolute në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me të cilën do të njihej gjenocidi i Serbisë në Kosovë.

Rezoluta e tillë, sipas tij, nuk do të kishte efekt juridik, por vetëm politik. "Rezolutat nuk janë obliguese (ligjërisht). Por, sidoqoftë, është ndoshta më shumë një fitore morale dhe politike sesa ligjore", thekson Arifi.

Në luftën e fundit në Kosovë janë vrarë rreth 13 mijë persona. Sipas autoriteteve të Kosovës, të zhdukur mbeten ende 1 617 njerëz.

Rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare pas përfundimit të luftës në Kosovë.

Krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nga viti 2000 deri në vitin 2008, ndërsa më pas nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX).

Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore.

# Haxhiu: 31 mjete transportuese të konfiskuara në Banjskë i jepen policisë për shfrytëzim

**Prishtinë, 4 prill** - Ministrja e Drejtësisë në Kosovë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije të enjten se 31 mjetet transportuese që autoritetet e Kosovës i kanë konfiskuar vitin e kaluar në Banjskë të Zveçanit i janë dhënë për shfrytëzim Policisë së Kosovës.

Më 24 shtator të vitit të kaluar, në Banjskë në veri të Kosovës, një grup i armatosur serb e ka sulmuar Policinë e Kosovës, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Më pas, në shkëmbim e sipër të zjarrit, janë vrarë edhe tre sulmues serbë.

Kosova e konsideron këtë sulm si terrorist dhe e fajëson shtetin e Serbisë për organizim dhe kryerje të tij, derisa Beogradi zyrtar mohon diçka të tillë.

Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, Millan Radoiçiq.

Haxhiu ka thënë të enjten para medieve se, përveç automjeteve, policia pati konfiskuar edhe vilën, restorantin dhe një banesë në emër të gruas së Radoiçiqit.

Radoiçiqi besohet se është në Serbi, por është i lirë.

Autoritetet e drejtësisë në Beograd kanë ngritur disa akuza ndaj tij, mirëpo e kanë lënë të lirë, duke ia ndaluar vetëm shkuarjen në Kosovë.

Haxhiu ka thënë se u bashkohet thirrjeve të vazhdueshme të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që rasti i Banjskës të trajtohet me prioritet nga institucionet përgjegjëse në Kosovë.

Edhe gjashtë muaj pas kryerjes së sulmit, për Radoiçiqin vazhdon të mos ketë një padi nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, ani pse një e tillë ishte paralajmëruar deri në fund të marsit të këtij viti. "Për ne është e habitshme se si ende nuk ka ndonjë aktakuzë, të paktën publikisht, kur tashmë dihen emrat e terroristëve, dihen emrat e kriminelëve, dihet se kush e ka udhëhequr këtë sulm terrorist. Ajo çka është e rëndësishme është që Prokuroria Speciale të veprojë në përputhje me përgjegjësitë dhe të mos ketë asnjë rast që nuk adresohet".



Në dhjetor të vitit të kaluar Agjencia Ndërkombëtare e Policisë (INTERPOL) ka lëshuar fletarrestim për të në dhjetor të vitit të kaluar, me kërkesë të Kosovës, përmes Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Daçiq, pati thënë se ekstradimi i Radoiçiqit në Kosovë është i pamundshëm, pasi të gjitha hetimet do të kryhen prej "gjykatave vendase".

Faktori ndërkombëtar ka bërë vazhdimisht thirrje që përgjegjësit e sulmit në Banjskë të përballen me drejtësinë. Radoiçiqi është i përfshirë në listën e zezë amerikane për pjesëmarrje në krim të organizuar ndërkombëtar.

# Krerët e shtetit e kujtojnë betejën e Koshares



**Prishtinë, 4 prill** - Në një seancë solemne të enjten, krerët e shtetit të Kosovës, presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe kryeparlamentari Glauk Konjufca, e kanë vlerësuar betejën e Koshares si historike për luftën çlirimin e vendit nga Serbia.

Me një minutë heshtje, deputetët e Kuvendit të Kosovës e shënuan 25-vjetorin e betejës së Koshares, që u zhvillua mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë serbe në perëndim të vendit gjatë luftës së viteve 1998/1999.

Presidentja Osmani tha se beteja e Koshares, e cila u zhvillua gjatë muajve prill-qershor 1999, është "operacioni më i madh ushtarak i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". "Sikurse edhe në shumë kapituj të historisë sonë të luftës, guximi, sakrifica dhe vendosmëria përmblidhen edhe në betejën e Koshares", tha Osmani.

Kryeministri Kurti tha se beteja e Koshares pasqyron tërë luftën e Kosovës "si në një format miniature, aty e shohim se në luftimet e betejës së Koshares janë të përfshirë luftëtarë dhe njësite nga të gjitha zonat operative të UÇK-së si dhe nga të gjitha trevat e banuara me shqiptarë", tha Kurti.

Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit të Kosovës, tha se kjo betejë shënoi mobilizim mbarëkombëtar në luftën për çlirimin e Kosovës nga okupimi serb. "Kjo betejë shënon një përbashkim të lartë kombëtar, një gjithëpërfshirje të të gjitha trevave e luftëtarëve që merrnin pjesë nga të gjitha viset e kombit tonë, duke përfshirë edhe mërgatën, e bënë këtë betejë një nga betejat më domethënëse në kuptimin e mobilizimit kombëtar shqiptar për çlirimin e Kosovës, sepse në Koshare luftoi e gjithë shqiptaria", tha Konjufca.

Luftimet në Betejën e Koshares u zhvilluan për 77 ditë me radhë, nga 9 prilli deri më 19 qershor 1999, në anën kufitare të Kosovës me Shqipërinë.

Gjatë atyre luftimeve u vranë 114 dhe u plagosën 423 luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## Presidentja Osmani priti në takim ambasadorin amerikan, flasin për zhvillimet e fundit në vend

**Prishtinë, 4 prill** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, priti të enjten në takim të rregullt ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier.

Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në vend me fokus të veçantë në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Më tutje, presidentja Osmani dhe ambasadori Hovenier diskutuan edhe për përgatitjet që po bëhen për mbajtjen e zgjedhjeve në veri, si dhe aspekte të ndryshme të bashkëpunimit bilateral.



# Kosova dhe Serbia, pa marrëveshje për dinarin në Bruksel

**Bruksel, 4 prill** - Kosova dhe Serbia nuk kanë arritur të pajtohen për çështjen e dinarit serb i cili u ndalua në Kosovë më 1 shkurt, as pas takimit të tretë radhazi të enjten në Bruksel, konfirmuan kryenegociatorët e të dy vende, të cilët e akuzuan njëri-tjetrin për mungesë vullneti për të gjetur një zgjidhje.
"Fatkeqësisht edhe sot kemi pasur dallime të mëdha", tha kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, duke folur për gazetarë pas takimit me homologun e vet serb Petar Petkoviq, nën ndërmjetësimin e të dërguarit të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak.
"Derisa pala kosovare ka diskutuar për opsionet se si serbët e Kosovës mund ta marrin mbështetjen financiare edhe më tej nga Serbia, pala serbe ka punuar si avokat i Postanska banka (Kursimorës së Postës serbe) dhe gjithë kohën ka diskutuar se si të licencohet ajo", tha Bislimi.
Ndërkohë, kryenegociatori i Serbisë, Petar Petkoviq, tha se Prishtina nuk tregoi "vullnet të mjaftueshëm" për një marrëveshje dhe se pritet edhe një takim lidhur me këtë temë.
"Ne përsëritëm edhe një herë qëndrimin dhe propozimin tonë, i cili është i balancuar dhe nënkupton një zgjidhje kompromisi. Nga ana tjetër, nuk kishte vullnet të mjaftueshëm nga ana e Prishtinës. Nuk do të flas më shumë për këtë, duke qenë se do të ketë një takim tjetër për këtë temë", tha ai.



Përdorimi i dinarit për pagesa me para të gatshme në Kosovë u ndalua më 1 shkurt, kur Banka Qendrore e Kosovës e futi në fuqi një rregullore të re e cila përcaktoi euron si valutën e vetme zyrtare në vend.
Në takimin e kaluar në Bruksel, Petkoviqi kishte thënë se pala serbe do të përpiqet ta vazhdojë funksionimin e bankës së Serbisë në Kosovë, Kursimora e Postës, në mënyrë që serbët t'i marrin pagat, pensionet dhe ndihmën tjetër.
Bislimi e akuzoi palën serbe se "nuk ishte e shqetësuar për qytetarët" dhe se shqetësimi i saj kryesor ishte si ta licencojnë autoritetet e Kosovës bankën e Serbisë në Kosovë, Kursimora e Postës. "Për herë të tretë sot e bënë të qartë se ne nuk jemi anëtarë të Bankës Qendrore dhe nuk mund të marrim vendime... e bëmë të qartë, po ashtu, se diçka që nuk është e ligjshme në Kosovë, nuk mund të jetë pjesë e zgjidhjes", tha Bislimi.

## Takimi i radhës, pas rreth dy javëve

Petkoviqi dhe Bislimi theksuan se do të ketë një takim të ri të katërt për këtë çështje pas rreth dy javëve. Bislimi tha se pala serbe nuk e pranoi një propozim të "konsoliduar" të Lajçakut, për të cilin "ne besojmë se është konstruktiv dhe në rrugën e duhur për të gjetur një zgjidhje, e cila më së shumti u shkon për shtat qytetarëve dhe e respekton rregulloren e Bankës Qendrore".
"Duhet të takohemi pas dy javëve. Atyre iu bë e qartë se ky do të jetë takimi i fundit, prandaj ata duhet të reflektojnë ose do të fajësojnë zyrtarisht për bllokimin e zgjidhjes", tha Bislimi.
Ndërkohë, Petkoviqi përsëriti se kjo çështje do të ishte e zgjidhur sikur të ekzistonte Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.
Të enjten më herët në mëngjes, Lajçaku e zhvilloi një takim dypalësh me kryenegociatorin serb Petkoviq.
Bashkimi Evropian, i cili e lehtëson dialogun mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, shpresonte se do të tejkaloheshin dallimet në qasje mes palëve dhe të arrihej një zgjidhje, sipas së cilës, qytetarët serbë në Kosovë do të mund të vazhdojnë t'i pranojnë beneficionet nga shteti serb. Kjo çështje, pos që zemëroi Serbinë, nxiti mospajtime edhe mes Qeverisë së Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, pasi komuniteti serb në Kosovë prej vitesh merr pagesa në dinarë nga buxheti i Serbisë.
Diplomatë perëndimorë i kërkuan Kosovës ta pezullojë rregulloren për t'u dhënë kohë qytetarëve të prekur të përshtaten me praktikën e re.
Takimi i së enjtes ishte i treti në javët e fundit mes kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi dhe atij të Serbisë, Petar Petkoviq, ndërsa i katërti në përgjithësi për këtë çështje në Bruksel.
Në takimet e deritanishme, sipas BE-së, palët kanë paraqitur propozimet e tyre për gjetjen e një zgjidhjeje praktike dhe afatshkurtër për qytetarët serbë në Kosovë që paguhen në dinarë nga Serbia.
Qeveria e Kosovës ngul këmbë se vendimi i BQK-së nuk është politik, por i një institucioni të pavarur. Megjithatë, ajo është shprehur e gatshme për një zgjidhje praktike që do t'u ndihmonte qytetarëve, por pa vënë në dyshim vendimin e BQK-së. Në një intervistë dhënë REL-it në mars, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nuk do të pranohen propozime për dinarin që janë në kundërshtim me rregulloren e BQK-së.

# Në BE arrihet marrëveshje për planin 6-miliardësh për rritje ekonomike në Ballkan

**Bruksel, 4 prill** - Parlamenti Evropian (PE) dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, të cilat përfaqësojnë 27 vendet anëtare të bllokut, kanë arritur marrëveshje të enjten për tekstin e vendimit për planin e BE-së për rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor, konfirmuan zyrtarët evropianë.
Negociatorët e Parlamentit Evropian, Tonino Picula dhe Karlo Resler, thanë se me këtë marrëveshje sigurohen 6 miliardë euro për reforma serioze ekonomike dhe strukturore përmes të cilave vendet e Ballkanit Perëndimor mund të shënojnë përparim më të madh në procesin e integrimeve evropiane.
Nga 6 miliardë euro, 2 miliardë do të jepen si grante pa kthim, ndërsa 4 miliardë në formën e kredive të favorshme.
Negociatat ndërmjet këtyre dy institucioneve të BE-së u zhvilluan nën një presion të madh kohor.
Tani, për miratimin formal të këtij plani, duhet të votojë edhe Parlamenti Evropian. Kjo pritet të ndodhë në seancën e fundit plenare para se të shpërbëhet Parlamenti Evropian në prag të zgjedhjeve të reja që zhvillohen në qershor.
Për shkak të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian në qershor, seancat e fundit plenare do të mbahen nga 21 deri më 24 prill.
Nëse plani dështon të votohet deri atëherë, ai do t'i mbetet në dorë përbërjes së re të Parlamentit Evropian, pra kah fundi i këtij viti.
Sipas marrëveshjes, vendet e rajonit për të përfituar nga kjo paketë e ndihmës financiare duhet t'i përmbushin një varg kriteresh jo dhe aq të lehta.
Në mesin e tyre janë kriteret bazike të cilat vlejnë njëlloj për të gjitha vendet anëtare. Ato kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, respektimin e parimeve të demokracisë, reformat institucionale dhe ndërmarrjen e hapave të domosdoshëm për të garantuar se mjetet nuk do të keqpërdoren.



Pos kritereve që kanë të bëjnë me reforma dhe sundimin e ligjit, ka edhe kritere të natyrës politike.
Për Kosovën dhe Serbinë parakusht tjetër do të jetë angazhimi konstruktiv në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre me qëllim të zbatimit të plotë të obligimeve përkatëse që dalin nga Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve dhe Aneksit për zbatimin, që u arritën më 2023 nën ndërmjetësimin e BE-së.
Ndërkohë, është tejkaluar mospajtimi rreth kushtëzimit apo jo të këtyre mjeteve me përshtatjen me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së. Ka dominuar qëndrimi i Komisionit Evropian dhe një numri më të madh të shteteve anëtare se ky nuk duhet të jetë parakusht specifik.

# Reportazh nga Kievi: Poezia, filozofia dhe alarmet e sulmeve

Nga: Amelia Glaser dhe Marci SHORE / **CNN (titulli origjinal: The heroism of Ukraine and the nihilism of Mike Johnson)**
Përkthimi: Agron Shala / *Telegrafi.com*

Të hënën në mëngjes, nga Krimea e pushtuar rusët lëshuan, drejt Kievit, dy raketa balistike hipersonike. Miqtë tanë dëgjuan shpërthimin dhe njëkohësisht edhe sirenat për sulm ajror – gjë që është e pazakontë. Raketat hipersonike janë më të shpejta sesa shpejtësia e zërit.

Fragmentet goditën Akademinë e Arteve Dekorative, të Aplikuara dhe Dizajnit, ku studentët, duke mos pasur kohë për të shkuar në strehimore, u shtrinë përtokë.

Kievi varet nga mbrojtja ajrore. Nga ana tjetër, mbrojtja ajrore varet nga ndihma amerikane dhe kjo ndihmë aktualisht mbahet peng nga kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, i cili për momentin është një ndër aleatët më të fuqishëm të presidentit rus Vladimir Putin.

Jemi studiuese amerikane të sllavistikës dhe sapo jemi kthyer nga Kievi. Nuk është e lehtë të shkosh atje këto ditë. Udhëtimi zgjat të paktën 36 orë nga Nju-Jorku. E morëm një fluturim të natës nga [aeroporti i Nju-Jorkut] JFK për në Varshavë – ku lufta nuk ndihet si shumë e largët. Nga Varshava i kaluam katër orë me tren për në qytetin kufitar polak të Çelmit. E, nga Çelmi i kaluam edhe 13 orë të tjera për të arritur në kryeqytetin ukrainas – me trenin ukrainas që mbërriti saktësisht në kohë.

Asnjëra prej nesh nuk ka qenë në Kiev qëkur koronavirusi mbylli botën.

“A keni dëgjuar se si përfundoi koronavirusi?” – thotë shakaja ukrainase.

“Bum! Bum! Bum”!

Kolegët tanë në Shkollën Ekonomike të Kievit donin që ne të ndiheshim të sigurta, kështu që e angazhuan Andriin, një zyrtar të gjatë policie që tashmë është në pension, për të qenë konsulenti ynë për sigurinë. Na këshilloi të instalonim dy aplikacione për sulm ajror dhe të përcjellim vendndodhjen e raketave në Telegram.

Të dielën në mbrëmje ishim duke u kthyer për në Kiev nga Buça – nga periferia e Kievit ku forcat ruse kryen masakër në marsin e vitit 2022 – dhe alarmi i parë u shfaq në telefonat tanë.

“Në rregull është”, dërgon Andrii një mesazh, “raketa është në anën tjetër të qytetit. Më dërgoni mesazh kur arrini të sigurta në shtëpi”.

Në Ukrainë janë të pandërprera alarmet për sulm ajror. Raketat vazhdojnë të vijnë. Të gjithë kanë humbur dikë. Por, Kievi lulëzon në mënyrën e vet. Në qendër të qytetit, një librari e re e quajtur Sens ka seksion të madh të letërsisë ukrainase dhe një kafene me ndriçim të mirë që shërben sallatën kinoa me avokado. Ka kafene elegante dhe është restoranti Crimean Tatar me meze rrepe dhe babaganush të mrekullueshëm.

Janë dy ekspozita të retrospektivës që shfaqin piktorin e ndjerë ukrainas të Valës së Re, Oleksandr Roytburd. Njëra prej tyre ka një linjë të vazhdueshme që dredha-dredha del nga galeria Pinchuk dhe matanë rrugës drejt tregut Besarabka. Roytburd vdiq nga kanceri, nga ndërlikimet që iu shkaktuan nga koronavirusi më 2021.

Piktorja monumentaliste Alla Horska u vra në vitin 1970, me shumë gjasa nga KGB-ja. Retrospektiva e saj e parë tani është e hapur në Shtëpinë e Ukrainës – një sallë ekspozite nga epoka sovjetike me atmosferë shpellore – pranë qendrës së qytetit. Kur ra një sirenë për sulm ajror, udhërrëfyesi i ekspozitës i inkurajoi vizitorët të zhvendoseshin në strehën për bomba: “Në katin e bodrumit ka një shërbim me pagesë dhe librari. Zbritni ju lutem dhe pini nga një filxhan kafe”.

Në Shkollën Ekonomike të Kievit [KSE], Tymofiy Mylovanov – presidenti i shkollës dhe ish-ministër i Tregtisë i Ukrainës – na tregoi dhomat e leksioneve nëntokësore në të cilat do të zhvendoseshin në rast të një alarmi për sulm ajror. Në seancat publike në KSE, Amelia foli me poetet Iya Kiva dhe Olena Huseinova për luftën që nuk mund të përkthehet dhe për urgjencën e përkthimit pavarësisht pamundësisë së saj.

Marci foli me filozofët Tetyana Ogarkova dhe Volodymyr Yermolenko – për Grenzerfahrungen, për “përvojat kufitare”. Çfarë ndodh kur qoshja bëhet qendër? Në diskutimin akademik, vdekja dikur ishte metaforë – vdekja e metafizikës, vdekja e autorit. Vdekja tani nuk është më metaforë. Publiku i tejmbushur qëndroi për më shumë se dy orë për të menduar për filozofinë dhe për luftën.

Këtë shkurt, Putini u mburr para Tucker Carlsonit për Traktatin Perejaslavit të vitit 1654, midis udhëheqësit kozak Bohdan Khmelnytsky dhe Moskës. Ky traktat, pretendonte ai, ia dha Rusisë të drejtën të kontrollonte Ukrainën bashkëkohore. Edhe Carlsoni dukej i habitur nga ky anakronizëm.

Khmelnytsky ishte udhëheqës kozak i cili kujtohet si kombndërtues në Ukrainë, si unifikues në Rusi, si tradhtar në Poloni. Hebrenjtë e kujtojnë si nxitës të masakrave. Në një diskutim në zyrat e Fulbrajtit në



Kiev rreth trashëgimive të ndryshme të Khmelnytskyt, historiani Oleksandr Halenko mendoi se Amelia, studiuese e studimeve hebraike, shumë shpejt jepi shpjegim përmes pogromeve. “A doje të ma bëje qejfin?”, donte të dinte. Ukraina, duke luftuar për mbijetesën e vet, po i rimendon gjithashtu ikonat e veta historike.

Në Kiev të gjithë janë të mësuar me luftën. Nuk mund ta injorojnë, madje janë mësuar me një ritëm jete që skalitet nga shtetrrethimi dhe nga sulmet ajrore të cilat mund të ndërpresin gjithçka në çdo moment. Ata e dinë se kanë pak kuptim debatet nëse Perëndimi mund ta paqësojë Putinin, duke ia bërë me dije se NATO nuk do të zgjerohet kurrë ose nëse Ukraina duhet të ngre qetash flamurin e bardhë dhe të negociojë.

Putini dhe aleatët e tij e kanë përqafuar praktikën e shkatërrimit, mesa duket për hir të shkatërrimit. Dhe, ukrainasit e dinë se as negociatat dhe as dorëzimi nuk janë të mundshme. Janë të përcaktuar që të vazhdojnë të jetojnë.

Në orën 12:49 të mëngjesit të së enjtes, më 21 mars, Andrii na dërgoi një mesazh me pikëçuditëse të kuqe: “Grupet e zbulimit raportojnë ngritjen e 10 Tu-95 nga baza ajrore Olenja. Mos e injoroni alarmin e sulmit ajror”! Dy minuta më vonë e shkroi përsëri një mesazh: “Me shumë gjasa mes orës pesë dhe gjashtë të mëngjesit do të ketë sulm masiv me raketa. Në rast alarmi, shkoni në strehimore”.

Ne të dyja jemi profesoresha të shkencave humane, jo specialiste të sigurisë. Kërkuam në Google për Tupolev ose Tu-95: ishte bombardues i madh me motor turboprop, i projektuar në vitet 1950 për të transportuar disa raketa në të njëjtën kohë dhe në distanca të mëdha. Rusia i përdori ato në Siri në vitin 2016. Tani u nisën nga baza ajrore Olenja, në jug të qytetit rus të Murmanskit.

Sirena e sulmit ajror erdhi në orën 3:21. Mbathëm këpucët, morëm xhaketat dhe telefonat dhe zbritëm në garazhin e parkingut nëntokësor – i ripërcaktuar si strehë për bombardimet në hotel. Telefonat e ndriçuan garazhin. Të gjithë i ndiqnin kanalet e Telegram-it, me lajmet me burime nga turma.

Ish-studenti i Marcit, Sergii, e shkroi një mesazh në një bisedë në grup: “Ulur në korridor, mes mureve”. Miku i tij iu përgjigj: “Të lutem shko në strehimoren për bomba”. Ka nivele të zgjedhjes: rri në shtrat; shko në vaskë ose në korridor ose në strehimoren në bodrum ose në stacionet e metrosë të cilat janë më të thella. Të ndërtuara në vitet 1950, me synimin për t’u dyfishuar si strehimore në rast të sulmit të NATO-s, ato janë opsioni më i sigurt. Sergii i dërgoi pamjet e ekranit nga kanalet në Telegram që ndoqi: “Mos u relaksoni. Vala e dytë po vjen pas pesëmbëdhjetë minutave”.

Motra e Sergiit dëgjoi shpërthimet në orën 5:00 të mëngjesit dhe më pas u kthye për të fjetur. Vendosi ta shfrytëzojë rastin. “Gjumi i shëndetshëm = psikikë e shëndetshme”, shkroi ajo.

Qëndruam në strehën e bombave teksa 31 raketa arritën në rajonin e Kievit. Alarmi përfundoi në orën 06:10 – dy orë e dyzet e nëntë minuta më vonë. Aplikacionet e të gjithëve më pas njoftuan në unison: “Vini re! Alarmi ajror mbaroi. Forca qoftë me ju”!

Të gjitha sinjalizimet për sulm ajror përfundojnë me “Forca qoftë me ju”! Mark Hamill – alias Luke Skywalker – ka vënë kontakte me Ukrainën.

Një grua në një kioskë pyeti se çfarë mendonim për sulmet. “Prita në banjë”, tha ajo. “Metro është shumë larg dhe nuk kam bodrum”.

Atë mëngjes, mbrojtja ajrore e Ukrainës rrëzoi 31 raketat ruse. Andrii na tregoi fotot që bëri nga dritarja e banesës – të raketave mbrojtëse të cilat arrinin objektivat. Mbi një duzinë e njerëzve u plagosën në periferi të Kievit, kur copat e raketave të shkatërruara ranë; disa ndërtesa janë dëmtuar dhe ka kratere të mëdha në tokë.

Kievi e ka mbrojtjen më të mirë ajrore në Ukrainë; vendit i mungojnë burimet për të mbrojtur qytetet e tjera në këtë mënyrë. Ndaj, qytetet e tjera nuk ia dalin mbanë.

Vetëm para agimit të së enjtes, Rusia – një vend ku miliona qytetarë janë shumë të varfër për të pasur ujë në shtëpi – shpenzoi rreth 390 milionë dollarë duke gjuajtur raketa në Ukrainë, thotë Agiya Zagrebelska, udhëheqësja e politikës së sanksioneve në Agjencinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit. Nihilizmi i këtij fakti është tronditës.

“Sa shkolla mund të ndërtoni me ekuivalentin e atyre parave …?” – na dërgoi një mesazh Arad Benkö, ambasadori austriak në Ukrainë.

“Pesimistët nuk i fitojnë luftërat”, ka thënë disa orë më vonë admirali Rob Bauer – kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s – para një audience në Forumin e Sigurisë në Kiev. Theksoi se mbrojtja ajrore e Ukrainës ka bërë punë spektakolare në atë mëngjes, duke rrëzuar çdo raketë të drejtuar kah Kievi.

“Nuk ka asgjë që nuk mund të bëni”, u tha Bauer ukrainasve, “e vetmja gjë që ju nevojitet është ndihma jonë”.

Por, ndihma e rinovuar nuk ka ardhur. Shtetet e Bashkuara në thelb kanë shmangur Ukrainën, dhe mbrojtja ajrore e Ukrainës me shpejtësi po i mbaron municionet. Është çështje e javëve – ose ditëve – para se të harxhohen.

“Më vjen mirë që erdhët tash”, na tha përkthyesja e letërsisë, Iaroslava Strikha. “Brenda disa javëve mund të mos kemi raketa mbrojtëse për ta mbajtur Kievin të sigurt”.

Mike Johnson, që varet nga Donald Trumpi i cili e ka lavdëruar Putinin, po i mban peng 42 milionë njerëz në Ukrainë. Në të gjithë Ukrainën, fëmijët varrosen vazhdimisht nën rrënoja – pasi vriten nga breshëria e raketave të Kremlinit.

Ukrainasit e dinë se jeta e tyre varet nga fakti nëse Johnsoni sjell ose jo Suplementin e Sigurisë Kombëtare në Dhomën e Përfaqësuesve. Polakët, lituanezët, letonët dhe estonezët e dinë se nga kjo varet edhe jeta e tyre: e dinë se lufta mund të kalojë në kufijtë e tyre në çdo moment, dhe se ukrainasit po luftojnë edhe për ata. Ndërsa, dalëngadalë dhe francezët dhe gjermanët po e kuptojnë se jemi sa një qime floku larg nga Lufta e Tretë Botërore.

Në hapjen e Forumit të Sigurisë, ish-kryeministri ukrainas, Arseniy Yatsenyuk, iu drejtua Johnsonit: “Bota të sheh. Je një i krishterë i devotshëm, z. Kryetar, kështu që Zoti gjithashtu të sheh”.

Putini, me paratë e naftës ka shumë më shumë burime ushtarake sesa Ukraina. Për më tepër, nuk e ka asnjë brengë për të shpenzuar gjithë pasurinë kombëtare të Rusisë – ose për të rrjedh gjak në gjithë popullin e vet. Kur jetët e njerëzve të tjerë nuk kanë kuptim për ty, atëherë e ke dorën e lirë për të vepruar.

Pasi aterruam përsëri në JFK, e fikim tingullin e sulmit ajror në telefonat tanë. Por, nuk e kemi fshirë aplikacionin. */Telegrafi/*

# DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (16)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

-74-
**Konfidenciale**

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
28 korrik 1981
I nderuar Alan,

**Kosova: situata e sigurisë**

Përmbledhje
1. Ka të dhëna se situata e sigurisë po qetësohet në qytetet kryesore të Kosovës dhe turistët po lejohen që të shkojnë në Kosovë në grupe të organizuara. Por në fshat dhe së fundmi në qytetet e zonave me popullsi shqiptare të Maqedonisë Perëndimore, ka të dhëna për vazhdimin e tensionit dhe incidenteve serioze.
Detaje
2. Bashkangjitur po ju dërgoj një raport të amerikanëve mbi katër dëshmi të drejtpërdrejta për situatën në Kosovë. Dëshmia e parë, e dhënë nga një ushtar i ri i cili kishte shkuar me leje nga njësia e tij jashtë Prishtinës, jep një pamje grafike të vazhdimit të dhunës dhe antagonizmit ndërkomunal. Dëshmia e dytë e dhënë nga një arkeolog serb, i cili kohët e fundit punonte afër Prishtinës, përshkruan padepërtueshmërinë në rrjetin e sigurisë. Gjithashtu, dëshmia e tretë dhe e katërt e dhënë respektivisht nga një student serb dhe një shqiptar, pasqyron atmosferën në Universitetin e Prishtinës.
3. As ne dhe as amerikanët nuk kemi ndonjë provë të fortë për të mbështetur historinë e ushtarit mbi "masakrat" apo vrasjet e përditshme. Me rifillimin e vitit shkollor në universitet në shtator pritet që një numër i konsiderueshëm rekrutësh të kthehen nga shërbimi i tyre ushtarak në Kosovë dhe ky informacion mund të verifikohet. Ndërkohë unë po e raportoj atë vetëm si një të vërtetë të mundshme.
4. Dëshmitë e tjera tingëllojnë të vërteta, me përjashtim të faktit që pikëpamja e arkeologut mbi frymëzimin kryesisht të jashtëm të demonstratave, nuk është mbështetur deri tani me prova të tjera.
5. Raportet e shtypit dhe televizionit mbi vazhdimin e atmosferës së tensionuar në disa pjesë të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore, janë konfirmuar nga dy zyrtarë të Ambasadës së SHBA-së këtu, të cilët morën leje të shkonin me makinë më 24 korrik nga Maqedonia në Mal të Zi për një punë konsullore përmes një rruge posaçërisht të përcaktuar që nuk lejonte ndalesa natën në Kosovë. Ata dëshmuan në Tetovë mbajtjen në shkallë të gjerë të qeleshes së bardhë kombëtare shqiptare si një demonstrim i qartë i kombësisë. Në qendër të Tetovës të cilën ata e përshkruan si një "kamp i armatosur", ishin thyer xhamat e Qendrës së Forcave të Armatosura dhe kudo përreth kishte roje të armatosura rëndë, përfshirë praninë e tyre në çati dhe në barrikada. Qyteti patrullohej nga grupe të milicisë së armatosur dhe milicia ishte vendosur në çdo pikë furnizimi me karburant. Kishte pika kontrolli të milicisë në hyrje të Kosovës nga Maqedonia dhe në dalje të Kosovës për në Mal të Zi, por nuk ishin bërë kontrolle në hyrje të qytetit në Ferizaj, Deçan, Pejë ose Gjakovë. Megjithatë, në të gjitha vendet kishte milicë të armatosur që patrullonin. Ata ishin sidomos të dallueshëm në Deçan. Në Ferizaj ata panë milicë të armatosur që udhëtonin në autobusë.
6. Kundrejt kësaj situate, kemi provat e Xhavit Nimanit në fjalimin e dorëheqjes së tij (letra ime e datës 21 korrik jo për të gjithë) se situata ishte qetësuar mjaftueshëm që ai të tërhiqej. Për më tepër, ishte njoftuar më 23 korrik nga Shoqata Turistike e Kosovës se lejoheshin turistët dhe vizitat e organizuara në Kosovë. Që atëherë na është konfirmuar nga Drejtoria Konsullore e Sekretariatit të Huaj se lejohen udhëtimet e organizuara por se kjo përbën të vetmin lehtësim, d.m.th. vizitat nga turistët, biznesmenët dhe diplomantët individualë nuk lejohen përveç se kur jepet leje e mëparshme e veçantë. Për më tepër, shtypi ka raportuar se janë rihapur kinematë dhe teatrot në qytetet kryesore, por se janë ende të ndaluara tubime të mëdha publike, të tilla si ndeshjet e futbollit. Gjithashtu, është njoftuar në shtyp më 27 korrik se në Mitrovicë, skena e trazirave të hershme, ishte propozuar që t'i jepej fund gjendjes së jashtëzakonshme meqenëse aty nuk kishte më "eksese". Raporti i shtypit iu referua përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme në pesë komuna të tjera (pa emër).
I Juaji,
T. J. Clark
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit
Zyrës së Kancelarit në Uashington
UKDEL NATO

-75-
**Konfidenciale**

**Beograd A - 111**
Një ushtar i ri. Një ushtar i ri, i cili është kthyer në shtëpi me leje nga njësia e tij aktualisht me detyrë për të ruajtur një objekt të "komunikimeve ushtarake" rreth 30 km nga Prishtina, solli disa të dhëna interesante mbi situatën e sigurisë në qytet dhe përreth tij si dhe mbi rolin e JNA-së aty. Sipas këtij kontakti, njësia e tij kufitare e ruajtjes ishte transferuar me nxitim me detyrë në Kosovë rreth dy muaj e gjysmë më parë. Njësia ishte vendosur në Varazdin në verilindje të Kroacisë, por në fund të prillit u zhvendos në Rijeka, ku, sipas burimit tonë, njësia mori armë të tjera, uniforma dhe pajisje të tjera si dhe stërvitje të papërcaktuar. Njësia kaloi dy javë në Rijeka, ku menjëherë më pas u transferua direkt në Kosovë. Gjatë dy muajve të ardhshëm njësia i kërkoi ushtarëve që të ruanin objekte të rëndësishme qeveritare të komunikimit (ai tha të tilla si, Radio TV e Prishtinës, zyra postare etj.) në Prishtinë dhe objekte ushtarake jashtë qytetit.
Ushtari i rojës kufitare foli në detaje mbi situatën e fundit dhe aktuale të sigurisë në Prishtinë dhe përreth saj. Ai raportoi se ekziston një tension i tmerrshëm, megjithëse është qetësuar disi gjatë javëve të fundit. Shqiptarët, veçanërisht rinia, janë haptazi armiqësorë ndaj serbëve dhe malazezëve si dhe ndaj anëtarëve të forcave të sigurisë. Armiqësia shqiptare shprehet në mënyra konkrete që përfshijnë të qëlluarit e policëve dhe ushtarëve nga pritat, sulmet individuale ndaj anëtarëve të policisë dhe JNA-së, si dhe gjuajtja me gurë nga grupe të rinjsh, dhe veprime të tjera provokative të tilla si pështymja dhe përdorimi i gjuhës blasfemike. Duke komentuar më tej mbi përdorimin e dhunës, ai pretendoi se deri vetëm pak javë më parë të qëlluarit nga pritat nuk ishte diçka e pazakontë në vetë qytetin e Prishtinës, por se ndërkohë që policia e kishte shtrënguar kontrollin e saj në qytet, të qëlluarit nga pritat pothuajse ishte zhdukur. Gjithsesi, ai shtoi se snajperët kanë mbetur aktivë në fshat dhe përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm për forcat e sigurisë. Ai vetë shprehu shqetësim të konsiderueshëm dhe frikë duke qenë se duhej të kthehej në njësinë e tij pas pak ditësh; ai është veçanërisht nervoz për faktin se i ka mbetur vetëm një muaj për të kryer në shërbimin ushtarak. Kontakti ynë vuri në dukje gjithashtu se trupat që ruajnë ndërtesat dhe objekte të tjera janë sulmuar nga shqiptarët që përdornin thika, veçanërisht natën. Sulme të tilla ndodhin më shpesh në zonat rurale; ai theksoi se detyra e shërbimit gjatë natës është ajo për të cilën trupat e JNA-së kanë realisht frikë.
I pyetur se çfarë kufizimesh kanë ushtarët në lidhje me përdorimin e armëve të zjarrit, i riu i rojës kufitare u shpreh se ai dhe shokët e tij kanë marrë urdhra të rrepta që të shmangin dhe të injorojnë provokimet dhe të mos, e përsëris, të mos përdornin armët e tyre të zjarrit përveçse kur u rrezikohej jeta. I pyetur për viktimat, ushtari i kalorësisë deklaroi se dy të tretat e ushtarëve vriten aktualisht çdo ditë, shumë prej tyre për shkak të snajperëve. Ai deklaroi se janë vrarë një numër ushtarësh nga njësia e tij dhe shtoi se në përgjithësi është pranuar se në Kosovë kanë vdekur rreth 1,000 njerëz që prej shpërthimit për herë të parë të trazirave atje. Në këtë drejtim, ai raportoi se disa milicë shqiptarë i tërhoqën kolegët e tyre serbë në fazat e hershme të trazirave në Kosovë dhe si rezultat i kësaj vdiqën një numër i caktuar nga të dyja palët.
Në lidhje me rolin e JNA, ai tha se - siç raportohet më lart - trupat ushtarake janë përdorur kryesisht për të ruajtur dhe siguruar objekte të rëndësishme civile dhe ushtarake. Policia - nacionale, lokale dhe "speciale" - ka përgjegjësi reale për ruajtjen e rendit publik. Sidoqoftë, ushtria ka një rol shtesë, atë të ndihmës për policinë - dhe ai vuri theksin në "policinë speciale" - në kryerjen e operacioneve kundër nacionalistëve të dyshuar shqiptarë dhe qendrave terroriste. Sapo zgjidhet një objektiv (fshat, lagje qyteti, etj.), trupat e JNA-së përdoren për rrethimin e tij, ku më pas sillet "policia speciale" shpesh me helikopter në zonat rurale. Burimi ynë pretendoi se në disa raste, kur ishte ndeshur në rezistencë të armatosur apo ishin zbuluar arka me armë, "policia speciale" dhe ushtria (duke përdorur tanke) shkatërronte plotësisht zonën e synuar, duke vrarë banorët e saj, përfshirë gratë dhe fëmijët. Ai pretendoi se disa fshatra shqiptare ishin rrafshuar përtokë në këtë mënyrë megjithëse e pranoi që personalisht nuk kishte marrë pjesë në operacione të tilla. Sipas këtij burimi, një numër ushtarësh me origjinë shqiptare janë anëtarë të kësaj njësie. Ato kanë mbetur në njësi dhe kanë qenë burimi i "problemeve" për të cilat ushtari i ri refuzoi të fliste. Megjithatë, ai tregoi se në një rast një ushtar shqiptar i kishte thënë (burimit tonë) se po ruante "një plumb për të". Ushtari i ri vlerësoi se janë rreth 600,000 trupa shtesë të JNA-së si dhe rreth 3,000 trupa kombëtare dhe të "policisë speciale" të caktuara aktualisht me detyrë për Kosovën.
Një arkeolog serb vizitor. Kemi folur gjithashtu me një arkeolog të ri serb i cili kaloi qershorin në Kosovë duke punuar në një "gërmim" afër Manastirit të Graçanicës, rreth 15 km në jug të Prishtinës. Burimi raportoi se situata në atë zonë dhe në vetë qytetin e Prishtinës (ku ai kaloi dy fundjava me miqtë) është "shumë e tensionuar". Policia e armatosur e ndarë në grupe prej dy dhe tre vetash patrullon rrugët e Prishtinës dhe fshatin me shumicë serbe afër Manastirit të Graçanicës. Policia - nacionale, lokale dhe "speciale" - është "kudo", theksoi ai. Si në Prishtinë dhe në fshat ata nuk hezitojnë të shpërndajnë qoftë edhe tubimet më të vogla të shqiptarëve. Ai vuri në dukje se në ruajtjen e rendit publik policia nuk është dalluar për kortezi dhe mirësjellje.
Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, të gjitha vendet e tubimeve publike ishin të mbyllura. Kështu, ai vuri në dukje se nuk kishe çfarë të bëje në Prishtinë përveç se të vizitoje miqtë në apartamentet e tyre dhe të pije e bisedoje me ta. Nuk ishte e sigurt që të qëndroje në rrugët e Prishtinës në mbrëmje dhe për këtë ai nuk lejohej të lëvizte në zonën midis Manastirit dhe fshatit afër pa një eskortë të armatosur në çdo moment të ditës dhe natës. Vetë Manastiri, meqenëse ishte zonë arkeologjike, ruhej gjatë gjithë kohës nga një njësi e vogël e JNA-së që kishte ngritur kampin ushtarak aty pranë. Në lidhje me forcat ushtarake, arkeologu vuri në dukje se pa shumë qarkullim të forcave ushtarake në rrugë dhe një numër të madh automjetesh të blinduara në Prishtinë dhe përreth saj. Sidoqoftë, përshtypja e tij e përgjithshme ishte se forcave ushtarake u ishte caktuar një rol "rezervë". Ai nuk i ka parë trupat e JNA-së që të kryenin realisht funksione të policisë me përjashtim të plotësimit të stafit në bllokimet e rrugëve. Shumica e trupave ushtarake që ai pa ishte vendosur në periferi të Prishtinës dhe vende të tjera të banuara.
Ne kishim folur me këtë burim përpara nisjes së tij për Kosovë, periudhë në të cilën ai shprehu pikëpamjen se trazirat ishin lokale për nga origjina. Megjithatë, qëndrimi i tij për një muaj ndryshoi plotësisht pikëpamjen e tij. Bazuar në biseda që pati me miqtë në Prishtinë dhe kosovarë të tjerë, ai tani beson me vendosmëri se trazirat janë kryesisht rezultat i frymëzimit të jashtëm. Ai pretendon se ka prova të pakundërshtueshme se demonstratat dhe rezistenca e mëvonshme në përpjekjet për të qetësuar Kosovën ishin të mirorganizuara, të koordinuara dhe të planifikuara që më parë. Ai është personalisht i bindur - siç janë mesa duket miqtë dhe të



njohurit e tij në Kosovë - se trazirat janë frymëzuar, mbështetur dhe mbase edhe organizuar nga vetë Shqipëria. Si një njeri i mirarsimuar, meditues i cili mund të përshkruhet më mirë si një person me pikëpamje të moderuara sociale dhe demokratike, i interesuar thellësisht në të kaluarën dhe i cili është në heshtje por thellësisht kritik ndaj sistemit aktual, udhëheqjes së tij e madje Titos, arkeologu flet sot për Kosovën me emocion të madh dhe si një nacionalist i rilindur serb.

Një studente shqiptare nga Prishtina. Kohët e fundit kemi pasur gjithashtu një bisedë të shkurtër me një vajzë të re shqiptare (studente e vitit të tretë në Universitet) e cila vizitonte Beogradin. Ajo është studente në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Universitetin e Prishtinës ku babai i saj është profesor në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (ai paguhet 16,000 dinarë në muaj, që është afërsisht dyfishi i mesatares së vendit dhe një pagë e shkëlqyer sipas standardeve të Beogradit). Ky burim hezitoi të fliste për problemin e Kosovës, duke preferuar që të fliste për situatën e saj. Ajo theksoi se kishte kaluar të gjitha testet e "besnikërisë", duke insistuar në të njëjtën kohë se nuk, e përsëris, nuk është anëtare e LKJ-së. Sidoqoftë, ajo na tregoi se ka një tension të konsiderueshëm në Universitet dhe në vetë qytetin e Prishtinës dhe se policia po bën - sipas mendimit të saj - një hetim të plotë të rrëmujave në Universitet. Në këtë drejtim, ajo tha se çdo student i cili "dyshohet" ose ndryshe konsiderohet "i pabesueshëm", arrestohet dhe merret në pyetje. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në rastin e saj dhe ajo është lejuar që të japë provimet në qershor megjithëse theksoi se të tjerët nuk u lejuan. Ajo nënkuptoi se ata që nuk ishin lejuar të jepnin provimet nuk do të lejoheshin të riktheheshin në fakultetet e tyre kur Universiteti të rihapej në shtator. Gjithashtu, ajo shtoi se kishte përshtypjen se nuk ishte vendosur ende nëse mësimi dhe leksionet do të mbaheshin në shtator dhe tetor, megjithëse ajo ishte e sigurt se provimet do të jepeshin si zakonisht në atë kohë.

Një studente serbe nga Prishtina. Përfundimisht, një vajzë e re serbe e cila sapo ishte diplomuar nga shkolla e mesme në Prishtinë dhe prindërit dhe mësuesit e së cilës janë prej një kohe të gjatë banorë të këtij qyteti, diskutoi me ne situatën e përgjithshme të kohëve të fundit. Ajo e përshkroi Prishtinën gjatë tre muajve të fundit si shumë të tensionuar dhe të pakëndshme. Ajo kishte pasur në plan të qëndronte në Prishtinë dhe të ndiqte universitetin aty, por trazirat e fundit e kishin nxitur që të largohej. Ajo është në Beograd për t'u regjistruar në universitet këtu, dhe nuk ka në plan të kthehet në Kosovë përgjithmonë. Demonstratat dhe "provokimet" të ndërmarra vazhdimisht nga shqiptarët, veçanërisht të rinjtë e moshës së shkollës së mesme dhe të rinjtë, e shqetësonin atë. Në këtë drejtim, ajo vuri në dukje se prej vitesh kishte dëgjuar prindërit e saj që flisnin me shumë neveri për trazirat e vitit 1968, ngjarje të cilat ajo tha se nuk mund t'i besonte deri kur ajo vetë të ishte personalisht dëshmitare e ngjarjeve që po ndodhnin në Prishtinë që në mars. Në përfundim, ajo vërejti se forcat e policisë dhe ato ushtarake kishin qenë shumë të kufizuara në trajtimin e tyre ndaj shqiptarëve, ku në shumicën e rasteve refuzonin që të ngacmoheshin nga sjellje provokative, duke përfshirë edhe disa raste të gjuajtjes me gurë.

Benson

**76-**
**Për përdorim të kufizuar**

J C R Gray
EsqAmbasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
28 korrik 1981
I nderuar Charles,

**Kosova: emigrimi i serbëve dhe malazezëve**

Përmbledhje

1. Në nivel zyrtar, është rritur shqetësimi për emigrimin e serbëve dhe malazezëve nga Kosova dhe për këtë është ngritur një komision hetimor. Megjithatë, deri tani nuk është bërë pothuajse asnjë progres në analizimin e shkaqeve të këtij emigrimi e aq më pak në marrjen e masave për ta parandaluar atë. Implikimet e ndryshimeve të shpejta demografike në Kosovë dhe përreth saj mbeten shqetësuese.

Detaje

2. Në letrën time për ju të datës 17 qershor përshkruhet shqetësimi zyrtar për shkallën e emigrimit të serbëve dhe malazezëve nga Kosova. Më 14 korrik, Kuvendi i Kosovës caktoi një Komision prej 16 anëtarësh për të hetuar sa më shpejt shkaqet e kësaj lëvizjeje dhe për t'i raportuar ato. Gazeta "Politika" e datës 27 dhe 28 korrik kishte dy ngjarje ku përshkruheshin vështirësitë që po kalon Komisioni në ndjekjen e këtij ekzaminimi.

3. Problemi i përgjithshëm i emigrimit nuk është nënvlerësuar nga autoritetet e Kosovës. Në mbledhjen e Komisionit më 24 korrik, Dushan Ristiç, kryetar i Kuvendit të Kosovës, tha se "emigrimi i serbëve dhe malazezëve nga Kosova përfaqëson një prej çështjeve më të rënda politike që kemi ndeshur në ndërtimin e shoqërisë sonë vetëmenaxhuese socialiste". Sidoqoftë, duket se që prej demonstratave të marsit dhe prillit është rritur numri i njerëzve që aplikojnë për dokumentacionin e rregullt në pritje për t'u larguar nga Krahina; vetëm në Prishtinë dhe Mitrovicë rreth 800 njerëz ishin aktualisht në procesin e largimit dhe 300 ishin larguar realisht nga Mitrovica që prej demonstratave, por nuk dihej vendndodhja e tyre. Megjithatë, siç e bëjnë të qartë raportet e gazetës "Politika" përpjekjet për të zbuluar shtrirjen e përgjithshme të emigrimit dhe për të identifikuar shkaqet e "presionit" deri tani kanë qenë tepër të pasuksesshme. Të gjitha komunitetet lokale dhe organizatat bazë të punës në Kosovë, është kërkuar që të raportojnë deri më 15 korrik se kur dhe pse personat kanë emigruar, por edhe dy javë pas afatit të dhënë duket se nuk është bërë asnjë raport i vetëm. Pjesa më e madhe (por jo të gjitha) e komunave kanë ngritur së paku komitete për të shqyrtuar problemin dhe për të studiuar kërkesat e reja për emigrim.

4. Gjithsesi, siç edhe demonstruan disa nga diskutimet e Komisionit më 27 korrik, do të jetë shumë e vështirë në mos e pamundur që Komisioni të vlerësojë tablonë e përgjithshme në lidhje me emigrimin. U zbulua se 2,750 njerëz ishin larguar nga Ferizaj gjatë dekadës së fundit, por që nuk ishin përcaktuar arsyet e tyre. 600 njerëz ishin larguar nga Suhareka por (supozohej si e pamundur) asnjë prej tyre nuk e kishte bërë këtë për shkak të presionit. U paraqitën analiza të tjera lokale. Megjithatë, raporti i gazetës "Politika" e bëri të qartë se informacionet e përftuara deri tani ishin të fragmentuara dhe jo të besueshme. Një gjë e tillë nuk është shumë e çuditshme, duke marrë parasysh mungesën e praktiticitetit në ndjekjen dhe marrjen në pyetje të njerëzve që ishin larguar nga Krahina dhe hezitimin e kuptueshëm të disa prej atyre që ishin në proces largimi për të bërë akuza të cilat mund të merreshin si "nacionaliste". Për më tepër, siç citohej në ekstraktin e marrë nga "NIN" (shkresa ime e referuar), "presioni" mund të marrë një larmi formash delikate ose jo aq delikate; kështu, mundësitë që Komisioni të jetë në gjendje të përpilojë analiza të hollësishme janë, për të mos thënë aspak, të pakta. Me gjithë vërejtjen e Husein Prekazit, kryetar i Komisionit, se nuk duhet nxituar në përgatitjen e konstatimeve pasi shkaqet ishin komplekse dhe spekulimi për këtë "çështje delikate" kërkonte përgjigje të kujdesshme, vetë Kuvendi i Kosovës duhet të shqyrtojë problemin e emigrimit në tetor dhe të ofrojë "një përgjigje të plotë".

5. Rastësisht, në diskutimet e raportuara disa folës tërhoqën vëmendjen në efektet e dëmshme që sjell për ekonominë e Kosovës emigrimi i teknikëve dhe punëtorëve të kualifikuar. Punëtorët serbë që aplikonin për vende pune ishin refuzuar vetëm për arsye gjuhësore. Largimi i ekspertëve dhe teknikëve është përshkruar si një "humbje e paripariueshme".

Komente

6. Edhe nëse eventualisht përcaktohet se pas shumë shkaqeve të emigrimit të serbëve dhe malazezëve nga Kosova është "presioni", nuk mund të bëhet shumë në klimën aktuale politike në këtë Krahinë për të ndaluar largime të tjera ose në të vërtetë, për të ndryshuar trendin. Praktikisht, do të ishte shumë e zorshme që njerëzit të parandalohen fizikisht për të mos u larguar nëse jeta për ta është bërë e patolerueshme në Kosovë; megjithatë deri tani nuk ka pasur sugjerime të ndjeshme për trajtimin e akteve të shumta të vogla të vandalizmit apo kërcënimeve anonime që mesa duket vazhdojnë (shpesh të kryera nga fëmijët). Ndërkohë, ndryshimet thelbësore demografike po vazhdojnë me ritme të shpejta. Siç përmendet në letrën time për ju, dërguar javën e kaluar, mbi ngjarjet nacionaliste në Maqedoni (paragrafi 2), kohët e fundit ka pasur një lëvizje të konsiderueshme të shqiptarëve nga Kosova për në krahinën e Tetovës. Deri kur të marrim statistika më të plota të popullsisë nga Censusi, nuk mund të dallojmë se deri në çfarë mase kanë qenë të ngjashme ndryshimet gjetkë në Maqedoninë Perëndimore dhe Serbinë Jugore, por është e sigurt të supozojmë se balanca e popullsisë në këto pjesë të Jugosllavisë po zhvendoset mjaft shpejt për shkak të normave të ndryshme të lindjes dhe lëvizjes reale të popullsisë. Kushdo do të pyeste nëse rregullimet aktuale kushtetuese do të jenë në gjendje që t'i qëndrojnë tensioneve afatgjata që këto zhvillime paralajmërojnë.

I Juaji,
C. G. Crawford

**-77-**
**Për përdorim të kufizuar**

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
28 korrik 1981
I nderuar Charles,

**Kosova: Universiteti i Prishtinës**

Përmbledhje

1. Autoritetet e Universitetit të Prishtinës kanë trajtuar gjatë dy muajve të fundit shumë probleme aty. Janë mbajtur mbledhje të shumta në mes fakulteteve dhe disa profesorë janë pushuar. Janë identifikuar praktika të mësimdhënies rastësore. Është ndërprerë bashkëpunimi me Universitetin e

Tiranës. Komunitetet lokale janë bërë përgjegjëse për studentët e tyre. Gjithashtu, janë përmirësuar objektet e studentëve. Rifillimi i studimit në tetor do të jetë një test i rëndësishëm për kontrollin e përgjithshëm të autoriteteve në Kosovë.

Detaje

2. Në letrën time për ju të datës 10 qershor (paragrafët 4-8), është identifikuar shtrirja e vështirësive me të cilat përballet Universiteti gjigant në Prishtinë dhe më pas kam raportuar emërimin e rektorit të ri (letra ime për ju e datës 15 korrik, paragrafi 6). Gjatë qershorit dhe korrikut autoritetet krahinore dhe të Universitetit janë marrë shumë me identifikimin e abuzimeve dhe përgatitjet për vitin e ri shkollor; gjithashtu, në një konferencë për shtyp më 27 korrik Rektori i ri, dr. Minir Dushi, vlerësoi progresin e bërë deri tani (përmbledhja ime ndalet në raportet e gazetës së sotme "Politika" dhe "Borba").

Praktikat e dobëta të mësimdhënies dhe përjashtimet nga LKK-ja.

3. Dr. Dushi raportoi se aktiviteti politik i kohëve të fundit në Universitetin e Prishtinës ka qenë "i gjallë", me mbledhje pothuajse të përditshme në të gjitha fakultetet e ndryshme për të trajtuar problemet individuale në lidhje me çështje të tilla si politika e kuadrove, bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, bursat dhe tekstet shkollore. Është zbuluar një shumëllojshmëri e praktikave të këqija të mësimdhënies; në veçanti, lektorët as që janë shqetësuar për t'u paraqitur në leksione dhe në vend të tyre kanë dhënë periudha përsëritjeje. Një gjë e tillë nuk do të ndodhë në të ardhmen. Akoma më keq, disa lektorë kanë ofruar ide nacionaliste në klasat e tyre (për të mos përmendur "historicizmin dhe romanticizmin kombëtar") dhe në këtë drejtim dy profesorë janë pushuar dhe përjashtuar nga LKK-ja, ndërkohë që është përjashtuar gjithashtu edhe sekretari lokal i LK-së së Organizatës së Rinisë. Aktualisht është vënë në dispozicion një shifër e saktë e popullsisë së studentëve (letra ime e datës 10 qershor, paragrafi 5): 28,608 studentë ishin regjistruar aktualisht në nivelet e ulëta apo të larta (siç do të kujtoni, vlerësimet e mëparshme të popullsisë së përgjithshme studentore ishin shumë më të larta - kjo shifër e re mund të heqë studentët me kohë të pjesshme).

4. Më 24 qershor gazeta "Politika" ka raportuar diskutimet e Këshillit të Universitetit, të datës 23, qershor ku u zbulua se gjatë vitit të fundit ishin larguar nga universiteti 64 mësues dhe asistentë serbë dhe malazezë (nga stafi i përgjithshëm mësimdhënës prej rreth 1,000 të tillë), megjithëse ishte pohuar se asnjë prej tyre nuk ishte larguar për shkak të "presionit". Gjithashtu, ishin punësuar lektorë të pakualifikuar. Është rekomanduar që vendet e stafit mësimdhënës të shpalleshin



në shtypin kombëtar në vend që të paraqiteshin vetëm në Kosovë. Ndërkohë që thuhej se dr. Dushi nuk i ka diskutuar këto pika, ai tha se ishte mjaft e vështirë për të plotësuar vendet e ofruara për studentët për vitin e ardhshëm akademik. Kishte kërkesa veçanërisht të ulëta në lidhje me mësimet e ofruara në gjuhën serbo-kroate për një sërë lëndësh; gjithsesi, "raundi" i dytë i procesit të regjistrimit pritej që të jepte rezultate shumë më të mira në këtë drejtim.

Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës

5. Gjatë javëve të fundit gazeta "Politika" kishte një numër të madh artikujsh në lidhje me bashkëpunimin kulturor me Tiranën, normalisht me të dhëna sipas të cilave vërshimi i "bashkëpunimit" nga Shqipëria në Jugosllavi ishte në mënyrë të konsiderueshme më i madh se vërshimi në drejtim të kundërt, dhe më 24 korrik gazeta "Politika" raportoi një mbledhje të Këshillit të përbashkët të universiteteve jugosllave në të cilën Universiteti i Prishtinës u kritikua ashpër sepse lejoi zhvillimin e një marrëdhënieje të njëanshme të papranueshme me Universitetin e Tiranës. Në konferencën e tij për shtyp, dr. Dushi njoftoi se ishte pezulluar bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës deri kur të krijoheshin kushte të reja.

Përgjegjësia e autoriteteve lokale

6. Siç është raportuar (në letrën time të datës 10 qershor, paragrafi 8), autoritetet lokale janë bërë përgjegjëse për kontrollin e studentëve në krahinën e tyre. Konferenca për shtyp e dr. Dushit zbuloi se ishin dërguar pranë autoriteteve lokale listat e studentëve që ishin akuzuar për kontrollin e sjelljes së studentëve të tyre në demonstrata. Disa komunitete e kishin bërë këtë detyrë me zell, por të tjerat jo. Në një mënyrë a në një tjetër "studentët e kësaj vjeshte të cilët janë të papërshtatshëm moralisht dhe politikisht, nuk do të lejohen të studiojnë. Universiteti ka hartuar kritere të reja për regjistrimin, bursat dhe akomodimin në konvikte. Çdo komunitet do të verifikojë përshtatshmërinë e studentëve të vet". Gjithashtu, në një mbledhje të Komitetit Krahinor të LKK-së më 25 korrik, u deklarua se "ishin vënë në zbatim shumë forma të ndryshme të punës ideologjiko-politike që përfshinin nxënësit, studentët, prindërit dhe mësuesit" si një kontribut për një vit të ri të suksesshëm akademik.

Kushtet e jetesës së studentëve

7. Në përfundim, dr. Dushi raportoi se janë marrë masa të ndryshme për përmirësimin e kushteve të jetesës në Universitet. Kishte përfunduar një konvikt i ri për 1,500 studentë dhe konviktet e tjera ishin rinovuar, ishte vënë në eficencë një radio stacion dhe ishte rritur numri i pajisjeve të shërbimit në mensën e studentëve. Mbetet për t'u parë nëse këto përmirësime do të lehtësojnë mjaftueshëm presionin në fakultetet e Universitetit, veçanërisht në konviktet e mbushura me studentë.

Komente

8. Nga Beogradi nuk është e lehtë të vlerësohen këto lëvizje që po bëjnë autoritetet e Universitetit për të kapërcyer shpërdorimet e përhapura administrative dhe akademike që janë zhvilluar gjatë viteve 1970. Padyshim do të duhet shumë kohë për të çrrënjosur të gjitha ekseset nacionaliste në një institucion kaq të madh në të cilin, padyshim vazhdojnë rivalitetet gjuhësore dhe kulturore; gjithashtu niveli i bashkëpunimit me përpjekjet "për të diferencuar" dhe promovuar vetëkritikën e rëndësishme ndryshon sipas fakulteteve. Gjithsesi, përmbajtja (dhe toni) e raporteve të shtypit sugjerojnë se rektori i ri po fillon të bëjë përparime dhe se janë në proces përgatitje të shumta me qëllim që rikthimi i studentëve në tetor të mos çojë në trazira të tjera. Meqenëse këto përgatitje përfshijnë jo vetëm Universitetin, por edhe zinxhirin e komandës së Partisë dhe Qeverisë deri në nivel lokal, shtrirja e suksesit të tyre do të na ndihmojë për të vlerësuar se si ka vijuar reagimi i përgjithshëm i autoriteteve të Kosovës ndaj trazirave të marsit dhe prillit.

I Juaji,
C. G. Crawford

-78-

**Konfidenciale**

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Beograd
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
31 korrik 1981
I nderuari Charles,

**Kosova: situata e sigurisë**

1. Në letrën time të datës 28 korrik për Alan Montgomery kam përmendur se Ambasada amerikane këtu ka arritur të rregullojë që dy nga nëpunësit e saj konsullorë të kalojnë në Kosovë përmes rrugës nga Maqedonia për në Mal të Zi. Amerikanët më kanë vënë në dispozicion një kopje të raportit të këtyre dy nëpunësve (përshkruar në raport si "Nëpunës i Ambasadës - Emboffs"). Raporti është tejet i gjatë dhe nuk ndryshon pothuaj aspak nga përmbledhja e shkurtër që kam bërë në letrën e përmendur më lart. Sidoqoftë, po ju dërgoj një kopje bashkangjitur kësaj letre në mënyrë që të merrni një tablo të plotë të situatës.

I Juaji,
T. J. Clark

**Raport i nëpunësve të Ambasadës - Emboffs**

2. Përmbledhje/koment i datës 24 korrik; dy punonjës të Ambasadës amerikane bënë vizitën e tyre të parë në Kosovë që prej trazirave të pranverës aty, duke kaluar në Kosovë me makinë personale nga Maqedonia për në Mal të Zi me miratimin e qeverisë. Kalimi ndodhi pa vështirësi dhe nëpunësit e ambasadës ndaluan për një kohë të shkurtër në Prizren, Deçan dhe Pejë. Duket se tani po lejohen kalimet për qëllime turistike: jeta në zonat rurale dukej normale; qytetet ishin të mbushura me aktivitete; megjithatë, prezenca e policisë ishte e madhe, veçanërisht në Ferizaj dhe në Manastirin e vjetër serb të Deçanit. Forcat ushtarake ishin më pak të dukshme. Gjatë vizitave të shkurtra në Tetovë, një qytet i Maqedonisë në kufi me Kosovën, nëpunësit e Ambasadës vunë re tension të konsiderueshëm duke përfshirë shenja të mundshme të trazirave të fundit si dhe një prezencë të madhe të policisë speciale dhe trupave ushtarake.

3. Përshtypja mbizotëruese e nëpunësve të Ambasadës për Kosovën - mbi bazën e pranueshme sipërfaqësore të kalimit të shpejtë me automobil - është ajo e një vendi të pushtuar. Megjithëse qytetet e Kosovës që duket se gëlojnë nga jeta e biznesi janë përsëri në rrëmujë, të habit prezenca e policisë - në rrugët që çojnë në qendrat kryesore, në rrugë, në bashkitë e mëdha dhe qendrat e komunikimit, në monumentet kulturore dhe në transportin publik. Kjo prezencë flet qartë për situatën atje. Mbetet për t'u parë se sa do të vazhdojë kjo situatë më gjatë. Fundi i përmbledhjes së komentit.

4. Nëpunësit e Ambasadës kaluan Kosovën me automjet personal, më 24 korrik, ku kërkesa e tyre për të kaluar ishte pranuar nga qeveria më 21 korrik (telegrami i referuar). Kalimi u bë nga Shkupi, Maqedonia për në Bijelo Polie, Mali i Zi përmes Kaçanikut, Ferizaj, Suharekë, Prizren, Gjakovë, Deçan dhe Pejë. Punonjësit e Ambasadës ndeshën në një postbllok të policisë 8 km në veri të Shkupit para se të hynin në Kosovë. Policia rrugore jugosllave kontrolloi të gjitha automjetet që hynin dhe dilnin. Pas paraqitjes së dokumenteve të SFPJ-së që autorizonin kalimin, policia i lejonte nëpunësit e Ambasadës që të vazhdonin rrugën. Policia ishte jashtëzakonisht e sjellshme. Vlen të përmendet se nuk kishte prezencë ushtarake në këtë pikë apo pika kontrolli që kontrollonin hyrjen në Kosovë nga Mali i Zi që ndodhet 5 km në jug të Bijelo Polie (në Mal të Zi). Policia në këto pika kontrolli mbante vetëm armë brezi. Megjithatë, nëpunësit e Ambasadës vunë re se forca të policisë speciale të armatosura me armë automatik ishin vendosur në pikat e rrugëve që çonin në kalimin e komuniteteve më të mëdha, d.m.th. Ferizaj, Prizren, Suharekë etj., megjithëse këto forca policie nuk u panë se



ndalonin qarkullimin. Organet e sigurisë jugosllave u dukën të qetë për udhëtimin e nëpunësve të Ambasadës. Nuk u vu re ndonjë mbikëqyrje e tyre, me gjithë kalimin nëpër disa zona - të tilla si Ferizaj - e cila sipas raportimit të shtypit jugosllav, shfaq ende probleme.

5. Aktualisht duket se po lejohet kalimi për qëllime turistike pa shoqërues në Kosovë, pa lejen e policisë (udhëtimet zyrtare ende kërkojnë leje). Siç raportohet në telegramin e referuar, më 23 korrik u njoftua se tashmë lejohet "turizmi i organizuar" (d.m.th. turnetë) për në Kosovë. Gjatë kalimit të tyre gjashtorësh, nëpunësit e Ambasadës vunë re se rreth 100 makina të huaja - afërsisht 70% e tyre ishin të Gjermanisë Perëndimore. Shumë prej tyre, ndoshta një e treta, duket se i përkisnin punëtorëve sezonalë (gastarbeiters) që ktheheshin nga punët verore për në Kosovë. Në lidhje me udhëtimet turistike, drejtori i qendrës kulturore amerikane në Shkup, shprehet se është në dijeni të faktit që disa turistë amerikanë kanë kaluar Kosovën gjatë dy javëve të fundit dhe që një grup amerikan i valles popullore ka marrë lejen për të udhëtuar nga Kosova për në Mal të Zi, më 18 korrik. Përpara se të bëhej udhëtimi duheshin marrë dokumentet përkatëse nga policia. Nëpunësit e Ambasadës pyetën gjithashtu në agjencinë e udhëtimit në Titograd, më 26 korrik, për mundësinë e një udhëtimi të huaj turistik për në Kosovë. Atyre iu tha se turistët e huaj lejoheshin aktualisht të kalonin në Kosovë duke përfshirë rrugën përmes Prishtinës për në Maqedoni dhe se kjo mund të realizohej pa marrë më përpara "dozvola" (leje) nga policia.

6. Kosova rurale. Fshati i parë nga rruga jep përshtypjen se jeta është relativisht normale aty. Nëpunësit e Ambasadës panë shumë njerëz që punonin në fusha dhe kujdeseshin për kafshët e fermave. Disa kultura janë duke u korrur. Fshatrat janë plot jetë; në disa prej tyre, tregjet fshatare ishin të mbushura me banorë lokalë dhe prezenca e forcave të sigurisë përfaqësohej zakonisht vetëm nga një polic. Në fshatrat shqiptare, u vu re se policët ishin shqiptarë.

7. Aktiviteti ekonomik. Edhe qytetet në të cilët kaluan punonjësit e Ambasadës dukej se kishin shumë gjallëri. Restorantet, kafenetë dhe mëngjesoret ishin të hapura në çdo lokal, përfshirë Ferizaj. Për shembull, nëpunësit e Ambasadës hëngrën drekën në një lokal të vogël në Prizren dhe kaluan pranë disa lokaleve të tjera të cilat po ashtu zhvillonin biznes aktiv. Bisedat me vendasit në Prizren dhe Pejë treguan se kinematë ishin hapur përsëri. Po kështu, ndërmarrjet e mëdha industriale dukeshin se funksionin dhe nëpunësit e Ambasadës vunë re vazhdimin e ndërtimit të disa komplekseve shumë të mëdha industriale, veçanërisht afër Suharekës.

8. Situata e sigurisë. Në përgjithësi ka një prezencë të shumtë të policisë në këtë pjesë të Kosovës megjithëse madhësia e saj ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Për shembull, në Ferizaj policia speciale e armatosur me armë të tipit AR kontrollon hyrjen për në qytet dhe patrullon rrugët e qytetit në grupe që përbëhen prej dy dhe tre vetash. Në mënyrë të ngjashme policia speciale e armatosur me armë të tipit AR apo mitralozë, ruan zyrën postare të qytetit, stacionin e energjisë elektrike dhe një institucion të paidentifikuar në qendër të qytetit. Në periferi të qytetit, ndërtesa e re e bashkisë është rrethuar nga tela me gjemba dhe shihen bunkerë të ndërtuar prej thasësh me rërë. Ushtarët e JNA-së që mbajnë helmeta dhe armë të tipit AR ruajnë sigurinë e kësaj ndërtese. Përveç kësaj, nëpunësit e Ambasadës panë një transportues të blinduar që dallohej nga ngjyrat e policisë speciale dhe disa kamionë të mëdhenj ushtarakë të parkuar në kompleksin e ndërtesës.

9. Në përgjithësi, nëpunësit e Ambasadës dalluan një model të aktivitetit të policisë: policia speciale që mbante armë të tipit AR ishte vendosur në ruajtje të zyrave postare, ndërtesave të qeverisë bashkiake, stacioneve të energjisë elektrike, stacioneve hekurudhore dhe të autobusëve dhe ndonjëherë të ndërmarrjeve industriale (nëpunësit e Ambasadës vunë re masa të ngjashme sigurie në Mal të Zi, Ivangrad dhe Rozhajë). Gjithashtu, në komunitetet më të mëdha policia speciale dhe lokale patrullonte rrugët në grupe prej dy vetash. Në Pejë, disa mbanin mitralozë; në vendet e tjera të vizituara, nëpunësit e Ambasadës vunë re se si policia lokale dhe ajo speciale mbanin vetëm armë brezi dhe shkopinj. Në Prizren milicia lokale që mbante vetëm armë brezi patrullonte shumë rrugët me automjete dhe në këmbë. Aty, dukej se milicia kontrollonte gjithashtu edhe vendet e tubimeve publike: ndërkohë që nëpunësit e Ambasadës hëngrën drekë në një lokal të vogël, një milic hyri dhe kontrolloi nga afër të pranishmit në mëngjesore. Por në shumë fshatra, veçanërisht në ato që dukeshin se ishin shqiptare, shpesh policia nuk ishte e dukshme. Megjithatë, në fshat nëpunësit e Ambasadës panë policë që hipnin në autobusët lokalë dhe autobusët ndërmjet qyteteve, veçanërisht në rrugën midis Ferizaj dhe Prizrenit.

10. Policia speciale është vënë gjithashtu për të ruajtur monumentet kulturore. Në Manastirin serb të Deçanit që është në gjysmë të rrugës midis Prizrenit dhe Pejës, ishin në shërbim forca të policisë speciale që mbanin mitralozë. Përveç kësaj, nëpunësit e Ambasadës vunë re ushtarë të JNA-së, të armatosur rëndë me veshje lufte që patrullonin rrugën pranë këtij Manastiri (i cili është afër kufirit me Shqipërinë). Ndërkohë që nëpunësit e Ambasadës vizituan Manastirin, një grup prej gjashtë ushtarësh të armatosur rëndë dhe me helmeta kaluan në zonën përreth Manastirit. Në të kundërt, në Patriarkanën e vjetër Ortodokse Serbe në Pejë, patrullonin vetëm policë të forcave speciale të armatosur rëndë dhe nuk shihej asnjë ushtarak.

11. Prania ushtarake. Në pjesën jugore dhe perëndimore të Kosovës ka prezencë ushtarake, por kjo prezencë nuk duket se është aq e madhe. Nëpunësit e Ambasadës panë një automjet ushtarak të rastit në rrugë, një autokolonë të vogël që përbëhej ndoshta nga një njësi komunikimesh midis Suharekës dhe Ferizaj dhe disa grupe ushtarësh të paarmatosur që shëtisnin në Prizren dhe Pejë. Garnizonet ushtarake në këto qytete duket se ishin relativisht të boshatisura. Në këtë drejtim, një maqedonas nga Bitola i tha nëpunësve të Ambasadës se njësia e djalit të tij, e cila ishte transferuar nga Bitola në Prizren menjëherë pas shpërthimit të trazirave aty, ishte zhvendosur më pas në Prishtinë dy muaj më parë.

12. Duke gjykuar nga prezenca e ushtrisë në Deçan, JNA-ja kishte një rol sigurie në këtë pjesë të Kosovës. Sidoqoftë, në përgjithësi duket se forcat e policisë speciale dhe lokale janë përgjegjëse për ruajtjen e rendit publik, veçanërisht në qytete ku ushtria mesa duket do të vihet në dispozicion për të ofruar çdo lloj mbështetjeje që mund të jetë e nevojshme si dhe për të garantuar sigurinë e monumenteve kulturore të rëndësishme serbe dhe ndoshta për të patrulluar fshatin.

13. Maqedonia. Duket se ka tension në rritje midis shqiptarëve dhe maqedonasve në zonën e Tetovës dhe Shkupit. Nëpunësit e Ambasadës kaluan më 22 dhe 23 korrik në Maqedoninë perëndimore dhe vunë re armiqësi të konsiderueshme kundër shqiptarëve në mesin e një numri të madh maqedonasish që ata takuan: nga një person i kontaktuar, atyre iu tha se "nëse ata (shqiptarët) duan luftën, ne do t'ua japim". Një person tjetër u tha se "e vetmja gjë e mirë e krijuar nga shqiptarët është marka Skënderbeg". Për më tepër, duket se policia maqedonase po merr masa të forta për të prapësuar aktivizmin shqiptar dhe për të kontrolluar lëvizjen e shqiptarëve me qëllimin e qartë për të kufizuar "nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar" në këtë pjesë të Maqedonisë, veçanërisht në Tetovë. Në Shkup, një e njohur studente australiane e cila ka shumë lidhje me komunitetin lokal shqiptar tha se kishte parë mbrëmjeve shtimin e kontrolleve të identifikimit nga ana e policisë në Shkup me synimin për të zbuluar shqiptarët joreszidentë. Ajo gjithashtu u tregoi nëpunësve të Ambasadës se kishte qenë personalisht dëshmitare kur shqiptarët i kishin ulur nga autobusët që udhëtonin për në Maqedoninë Lindore. Të njohurit shqiptarë të nëpunësve të Ambasadës hezitonin të diskutonin mbi situatën e tyre në Shkup, por treguan se shqiptarët ishin më mirë ekonomikisht tani në Kosovë sesa në kryeqytetin e Maqedonisë.

14. Qyteti i Tetovës, në veriperëndim të Shkupit dhe afër Kosovës, dukej veçanërisht i tensionuar. Tetova është një qytet ku më së shumti mbizotërojnë shqiptarët; ky fakt u bë tejet i qartë për nëpunësit e Ambasadës kur kaluan aty më 22 dhe 23 korrik, pasi në asnjë moment gjatë kalimit të tyre në Kosovë ata nuk vunë re kaq shumë njerëz të të gjitha moshave që mbanin qeleshe të bardhë e cila ishte bërë mënyra kryesore që meshkujt shqiptarë të manifestonin kombësinë e tyre nga njëra anë, dhe nga ana tjetër ishte bërë burim provokimi për nacionalistët serbë dhe maqedonas. Prezenca e policisë në Tetovë ishte e ngjashme me atë të vënë re në qytetet e Kosovës, pra shumë e madhe. Për më tepër, kur nëpunësit e Ambasadës kaluan përmes Tetovës gjatë mbrëmjes së datës 23 korrik, ata dalluan ushtarë të armatosur rëndë me veshje lufte të cilët ruanin (duke përfshirë disa të vendosur në çatinë e ndërtesës) klubin e ushtrisë në qendër të qytetit në dukje të posa fortifikuar (me thasë me rërë); përveç kësaj, nëpunësit e Ambasadës vunë re se pjesa më e madhe e xhamave të klubit ishin thyer, gjë që tregonte se aty kishin ndodhur trazira. Në përfundim, gjatë largimit nga Tetova atë mbrëmje, nëpunësit e Ambasadës ndeshën një pikë kontrolli të milicisë që ishte pikërisht jashtë qytetit në rrugën për në Shkup. Një ditë më parë aty kishte pasur një pikë kontrolli midis dy qyteteve. Policia i kontrolloi të gjithë njerëzit që qarkullonin në të dyja drejtimet, por i lejoi nëpunësit e Ambasadës që të kalonin pasi u panë dokumentet e tyre diplomatike.

Koment: treguesit e jashtëm të tensionit në Tetovë sugjerojnë se ekziston mundësia që aty të ketë trazira të tjera të cilat në fakt mund të provokohen nga masat e ashpra të sigurisë të miratuara nga autoritetet maqedonase, të shoqëruara me një valë të madhe të nacionalizmit maqedonas.

Benson




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Palokaj mundi çekun e pamposhtur Pokory

OBERHAUSE, 4 PRILL - Gjoni Palokaj me prejardhje nga Prizreni e që është pjesë e klubit Fightschool Hannover, ka shënuar fitore ndaj çekut, Jaroslav Pokory në kategorinë 66 kg në luftën në kafaz – MMA. Palokaj e mundi në raunde çekun Pokory, i cili nuk e kishte asnjë disfatë për 26 meçe në Çeki. Meçi u mbajt në Gejrmani në "Rudolf Weber Arena", në Oberhause, që e ndoqën rreth 15 mijë shikues. Pokory cilësohej si kundërshtar i vështirë ngase rangohej në vendin e 5-të në Octogon. Mirëpo, Gjoni ishte tejet i disiplinuar dhe e mundi me pikë kundërshtarin, duke fituar në tre raunde. Prizrenasi, ka ambicie të kalojë në UFC, por pasi që ka nënshkruar me Oktagon, i duhet ta bëjë edhe një meç e më pas kalon në kategorinë UFC, pasi që pas meçit me çekun, ishte në Miami te "American Top Tem". "Falënderoj, gjithmonë bashkatdhetarët e mi që më përkrahin kudo dhe në numër të madh. Kështu ishte dhe në meçin e fundit ndaj çekut në Oberhausen ku me përkrahjen e tyre arrita fitore", ka thënë të enjten Palokaj, duke shtuar se është krenar që është shqiptar (me origjinë nga Velezha e Prizrenit), ndonëse ka lindur dhe është rritur në Gjermani.



# MKRS-ja ndan 9 milionë euro për renovimin e stadiumit në Gjakovë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar me anë të faqes zyrtare se ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Komunën e Gjakovës, qëllimi i të cilit është krijimi i kornizës ligjore për bashkëpunimin dhe financimin e zbatimit të projektit për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjakovë. Pas stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë, "Adem Jashari" në Mitrovicë dhe atyre të qytetit në Pejë dhe Gjilan, MKRS ka në plan edhe rinovimin e "Stadiumit të Qytetit" në Gjakovë. Është vet MKRS-ja që ka njoftuar me anë të faqes zyrtare se kanë nënshkruar marrëveshje me Komunën e Gjakovës, ku vet zotohen të sigurojnë mjetet financiare prej nëntë milionë eurove, ndërsa Komuna ka për obligim zhvillimin e procedurave të prokurimit, punët ndërtimore si dhe mbikëqyrjen teknike. "Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi mes Ministrisë së Sportit dhe Komunës së Gjakovës, qëllimi i të cilit është krijimi i kornizës ligjore për bashkëpunimin dhe financimin e zbatimit të projektit për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjakovë". "Sipas këtij memorandumi, MKRS-ja merr përsipër sigurimin e mjeteve financiare në shumën prej 9 milionë euro për vitet 2024, 2025 dhe 2026, ndërsa komuna ka për obligim zhvillimin e procedurave të prokurimit, punët ndërtimore si dhe mbikëqyrjen teknike". "Memorandumi i bashkëpunimit është nënshkruar ndërmjet u.d sekretarit të përgjithshëm të MKRS-së, Xheladin Krasniqi dhe kryetarit të Gjakovës, Ardian Gjini", thuhet në njoftimin e






MKRS-së. Ministri i Sportit, Hajrulla Çeku ka thënë se futbollistët dhe qytetarët e Gjakovës dhe më gjerë do të kenë stadiumin e merituar, me kushte të dinjitetshme për të zhvilluar aktivitetet sportive dhe ndjekur ndeshjet e ekipeve të preferuara. "Stadiumi i qytetit në Gjakovë do të rinovohet. Për ta bërë të mundur këtë kemi ndarë 9 milionë euro. Kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Komunën e Gjakovës, përmes së cilës ne kemi zotuar gjithë buxhetin e nevojshëm për përfundimin e stadiumit, ndërsa komuna ka për obligim zhvillimin e procedurave të prokurimit, punët ndërtimore si dhe mbikëqyrjen teknike. Futbollistët dhe qytetarët e kësaj komune dhe më gjerë do të kenë stadiumin e merituar, me kushte të dinjitetshme për të zhvilluar aktivitetet sportive dhe ndjekur ndeshjet e ekipeve të preferuara", ka shkruar Çeku.

# Kuka: Edhe në Paris pres medalje nga xhudo



Prishtinë, 4 prill - Kur kanë mbetur edhe pak më shumë se 100 ditë deri Lojërat Olimpike që do të zhvillohen në Paris, Federata Botërore e Xhudos ka rikujtuar suksesin historik të Distria Krasniqi e cila ishte shpallur kampione olimpike në Tokio 2020 në kategorinë deri në 48 kilogramë. Përmes fotove është shpërfaqur suksesi i xhudistes kosovare dhe për këtë postim ka reaguar edhe trajneri i ekipit kosovar të xhudos, Driton Kuka i cili përmes një shkrimi në rrjetet sociale ka thënë se për medalje do të luftohet edhe në Lojërat Olimpike "Parisi 2024". "Për një ditë të mirë... Federata Botërore e xhudos përkujton triumfin me foto të bukura të Kampiones sonë Olimpike Disit! Tash diç më shumë se 100 ditë deri te Lojërat Olimpike në Paris!. Kosova tashmë i ka tri medalje olimpike me sportin e xhudos, shpresoj në medalje edhe në Paris. Ndryshe, Lojërat Olimpike do të zhvillohen nga 26 korrik deri më 11 gusht të këtij viti", ka shkruar Kuka.

## Gjyqtareve nga Kosova i besohet ndarja e drejtësisë në ndeshjen kualifikuese për 'Euro 2025'

PRISHTINË, 4 PRILL - UEFA i ka besuar gjykimin e ndeshjes Greqi-Ishujt Faroe, gjyqtares kryesore nga Kosova, Rita Vehapi dhe asistenteve Lumturije Muhadri e Rinesa Kryeziu. Gjyqtare e katërt do të jetë Festina Koxha. Katërshja e gjyqtareve nga Kosova do të drejtojnë ndeshjen kualifikuese për Evropianin e vajzave në Ligën C, Grupi C3, ndërmjet Greqisë dhe Ishujve Faroe. Kjo ndeshje që do të gjykohet nga Vehapi, Muhadri, Kryeziu dhe Koxha do të zhvillohet të premten, më 5 prill në Greqi, nga ora 19:00. Kjo është herë e treta që gjyqtaret nga Kosova ndajnë drejtësinë në një ndeshje të këtij niveli i futbollit të vajzave. Sipas FFK-së, suksesi i tyre është një dëshmi e fokusit të vazhdueshëm në zhvillimin e futbollit të femrave në vendin tonë, duke ndihmuar në afirmimin e vlerave të sportit dhe përkushtimit.



## Kosova zhvilloi përballjet e dyta



PRISHTINË, 4 PRILL - Kosova të premten ka zhvilluar dy ndeshje me Turqinë në YDF-së të Rumanisë. Përballjet kanë qenë shumë të vështira, duke marrë parasysh se përballë kishin Turqinë. Takimet janë zhvilluar me U14 në të dyja konkurrencat. Në konkurrencën e meshkujve, Turqia fitoi 47:96, ku dhjetë minutat e fundit të ndeshjes ishin të barabarta (20:20). Lum Gega kishte 18 pikë e 11 kërcime, derisa Narti Kasapolli shtoi 18 pikë. Ndërkohë, në konkurrencën e femrave, Turqia shënoi fitore 12:97, që ishte humbja e dytë për vajzat e Kosovës në këtë turne. Kosova të premten do të përballet me Rumaninë, kurse të dielën me Maqedoninë Veriore.

# Rrëfehet Hamilton: Në vitin 2021 ma vodhën titullin

LONDWR, 4 PRILL - "E kuptoj që nuk mund të vrapoj përgjithmonë. Sapo të ndalem, do të lë mikrofonin e radiokomunikimit dhe do të jem një person i lumtur. Problemi i vërtetë është se dua të bëj gjithçka, por e kuptoj se kjo gjë nuk mund të realizohet. Megjithatë, unë jam shumë ambicioz". Është kjo deklarata e Lewis Hamilton, pilotit britanik 7 herë kampion bote në Formula 1 për "GQ", në prag të garës së Suzuka këtë fundjavë në Japoni. "Në fakt, asgjë nuk është e pamundur, por për t'u bërë mjeshtër në diçka, duhen dhjetë mijë orë. Nuk ka kohë të mjaftueshme për t'u bërë një mjeshtër në të gjitha këto disiplina. Pasi të largohem nga Formula 1 mendoj se do të merrem me kinema dhe modë", tha më tej Hamilton. Duke folur për kalimin e tij te Ferrari vitin tjetër, ai shprehet: "Ishte një dëshirë e pavetëdijshme e lidhur me periudhën e parë të jetës sime. Por ka qenë gjithmonë një objektiv i rëndësishëm për mua. Për momentin, unë dua ta çoj Mercedesin në potencialin e tij të plotë këtë sezon". Hamilton zotohet t'i përkushtohet kauzës së Mercedes për kampionatin botëror, por në të njëjtën kohë ka vështrimin e tij drejt së ardhmes. Ai i menjëhershëm (2025 në Ferrari) por mbi të gjitha ai



afatmesëm, pas përfundimit të karrierës së tij të jashtëzakonshme në Formula 1. "Unë kurrë nuk kam filluar një vit duke menduar për vitin e ardhshëm. Mendimi im kryesor i përgjigjet vetëm një pyetjeje: Si mund ta përfundoj vitin më të mirë ndonjëherë me ekipin tim aktual, pas gjithë sezoneve triumfale të kaluar së bashku? Unë jam duke u stërvitur më shumë se kurrë", ka shtuar Hamilton. "Ndihem fizikisht më i përgatitur se në çdo sezon tjetër. Kështu që jam shumë i emocionuar për të tashmen, i vetëdijshëm se nuk mund të bëj më mirë se kaq. Në të njëjtën kohë po krijoj ide të reja, projekte që dua t'i zbatoj në fazën tjetër", u shpreh piloti britanik. Gjatë intervistës, Hamilton foli për garën e diskutueshme në Abu Dhabi në vitin 2021, ku humbi titullin e tetë kampion: "A më kanë grabitur? Është e qartë. Megjithatë, mbaj me vete një kujtim të çmuar të asaj dite: Praninë e babait tim. Kishim kaluar së bashku slitën e jetës, me ulje-ngritje dhe në ditën më të dhimbshme ai ishte aty. Ai më mësoi të eci përpara me kokën lart". "Natyrisht shkova për të uruar Max, pa i kuptuar pasojat negative të asaj që kishte ndodhur. Më dukej sikur një pjesë e imja po e shikonte atë që bëja. Ky ishte momenti përcaktues i jetës sime. Nëse i shoh sërish imazhet, më dhemb, por jam në paqe me veten", ka shtuar Hamilton.

# Minnesota e Bostoni udhëheqin Konferencat, vijon marshimi i Lakersave, zhgënjen Milwaukee

BOSTON, 4 PRILL - Vijon momenti i mirë në kampionat për skuadrën e Lakersat, që fituan me rezultat 125-120 në fushën e Washingtonit. Të gjithë titullarët e ekipit kalifornian realizuan mbi 16 pikë, ku u dallua Davis me 35 pikë e 18 rebound, mbështetur nga LeBron me 25 pikë. Bostoni bëhet ekipi i parë që arrin kuotën e 60 fitoreve në sezonin e rregullt në NBA këtë vit. Skuadra e Celtics fitoi me rezultat 135-100 ndaj Oklahomas. Treshja Porzingis-Tatum-Brown realizoi 74 pikë, duke bërë diferencën në fushë. Sërish ndryshon kreu i renditjes në



Perëndim, ku tashmë ndodhet Minnesota, që mundi me rezultat 133-108 Torontон. Ndeshje e dominuar nga vendasit, ku u dallua Anthony Edwards me 28 pikë. Zhgënjen sërish Milwaukee, që në fushën e tij u mund me rezultat 111-101 nga Memphisi. Për miqtë u dallua Jaren Jackson me 35 pikë. Në zonën "play-off" ndodhet edhe Phoenixi, që mundi me shifrat 122-101 Clevelandin, me Booker që realizoi 40 pikë e Durant 32 pikë.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Charlotte - Portland | 86-89 |
| Washington - Lakers | 120-125 |
| Atlanta - Detroit | 121-113 |
| Boston - Oklahoma | 135-100 |
| Brooklyn - Indiana | 115-111 |
| Milwaukee - Memphis | 101-111 |
| Minnesota - Toronto | 133-85 |
| New Orleans - Orlando | 108-117 |
| Phoenix - Cleveland | 122-101 |

## SHKURT

### Xhaka: Shihemi në Berlin

Granit Xhaka e bëri një tjetër arritje me Bayer Leverkusenin. Ylli kosovar arriti të kualifikohet në finale të Kupës së Gjermanisë pasi "Farmaceutikët" e mposhtën Dusseldorfin në gjysmëfinale me rezultat të thellë, 4-0. Wirtz me dy gola dhe Adli e Frimpong me nga një shënuan për Leverkusenin, i cili pasi e ka kryer thuajse punën sa i përket titullit të kampionit në Bundesligë, po shkon me hapa të sigurt drejt fitimit të një tjetër trofeut. E pas fitores përfaqësuesi zviceran e bëri një postim në rrjetet sociale. "Shihemi në Berlin", ka shkruar Xhaka në gjuhën angleze. Në finalen e DFB Pokal, e cila do të luhet në Berlin, Bayer Leverkusen do të përballet me Kaiserslauternin. Kuqezinjtë po i thyejnë krejt rekordet, ndërsa mbrëmë e kaluan ndeshjen e 40-të pa humbje.

### Beshiktashi refuzon ofertën e Aston Villas për Muçin

Ernest Muçi është një nga futbollistët më të mirë shqiptarë. Në merkaton e dimrit, sulmuesi kuqezi u transferua nga Legia e Varshavës te Beshiktashi, skuadër tek e cila u përshtat mjaft shpejt. Së fundmi u përfol për një interesim të Aston Villa. Zërat që qarkullojnë duket se kanë një të vërtetë, pasi presidenti i Beshiktashi, Hasan Arat në një intervistë të dhënë ka thënë se ka refuzuar 20 milionë euro për lojtarin. "Një klub nga Evropa bëri një ofertë prej 20 milionë eurosh për Ernest Muçin, por unë e refuzova ofertën", ka thënë presidenti. 23-vjeçari ka luajtur deri më tani në 6 ndeshje, ku ka realizuar 2 gola.

### Arteta: Titulli? Nuk është në dorën tonë

Arsenali fitoi 2-0 ndaj Lutonit dhe tash renditet në vendin e parë me një pikë me shumë se Liverpooli, por "Reds" kanë një ndeshje me pak. Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta ka thënë asgjë nuk është në dorën e tyre sa i përket titullit të kampionit në Angli, por që do të mundohen t'i fitojnë të gjitha ndeshjet. "Arritëm të bënim pak rotacion duke freskuar ekipin. Kush hyri në fushë bëri mirë. Pas disa ditësh kemi një tjetër ndeshje, luajmë në transfertë përballë Brightonit, Gara për titull? Ne dëshirojmë të jemi top në këtë fund sezoni. Të fitojmë ndeshjet tona është e vetmja gjë që kemi në dorë", u shpreh Arteta.

### Barcelona kërkon zëvendësuesin e Busquets, ja shtatë alternativat

Barcelona vazhdon kërkimet në merkato për të gjetur një zëvendësues të denjë të Sergo Busquets, i cili i është bashkuar Lionel Messit tek Inter Miami. Sipas "Mundo Deportivo"-s, drejtori sportiv Deco ka si përparësi gjetjen e një numri 6 të nivelit të lartë këtë verë dhe ka filluar të kërkojë që tani. Barcelona nuk ka qenë e njëjta pa fituesin e Kupës së Botës në këtë sezon. Mesfushori i Evertonit, Amadou Onana, duket se është objektivi kryesor për katalanasit për shkak të moshës së tij, aftësive teknike dhe fizikalitetit. Ylli i Bayern Munich, Josha Kimmich dhe ai i Real Sociedad, Martin Zubimendi, janë gjithashtu pjesës e listës. Khephren Thuram i Nice, djali i Lilian Thuram dhe Aleix Garcia. Mesfushori i Napoli-t, Stanislav Lobotka, gjithashtu konsiderohet një opsion. Emri i fundit në listën e Barcelona-s është mesfushori veteran i Arsenalit, Jorginho, i cili ka qenë prej kohësh një objektiv i katalanasve.

## Verstappen: Në Suzuka për të shlyer zhgënjimin e dy javëve më parë në Australi

Gara e fundit në Australi, që u mbyll me një fitore të dyfishtë të Ferrari dhe tërheqjen e Max Verstappen, bëri që botërori i Formula 1 të jetë mjaft i ekuilibruar. Kampioni i botës ka vetëm 4 pikë avantazh ndaj Charles Leclerc, ndaj gara e radhës në Japoni pritet me interes për të parë gjendjen e dy skuadrave. Moti mund të rezervojë disa surpriza, pasi parashikohet kohë me shi, që sigurisht nuk është diçka e re në pistën e Suzuka, ku Verstappen ka fituar dy vitet e fundit. "Synimi është të fitojmë sërish për të shlyer zeron në Austral. Suzuka është një pistë fantastike për të garuar", ka thënë Verstappen. "Gara e fundit në Melburn ishte e pafat dhe këto gjëra ndodhin në sportin tonë. Ne po vinim nga nëntë fitore radhazi, një seri e jashtëzakonshme. Ekipi është i sigurt për një paraqitje të mirë në pistën e Suzuka. Është një pistë ikonë dhe është gjithmonë kënaqësi të garosh aty", ka shtuar Verstappen. "Pista ka shumë kthesa me shpejtësi të lartë dhe degradim të lartë të gomave, ndaj duhet të sigurohemi që të optimizojmë performancën tonë aty ku është e mundur. Veçanërisht me parashikimin e shiut për këtë fundjavë. Mezi pres të kthehem në makinë dhe të jem gati të luftoj për fitore këtë fundjavë", u shpreh holandezi i Red Bull.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

**Datë, 05.04.2024**

Në bazë të neneve 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 si dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"* në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "*Ali Hadri*", Instituti i Historisë "*Ali Hadri*" në Prishtinë shpallë:

## KONKURS

1. (1) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për Kohën e re, zgjedhje/rizgjedhje;
2. (2) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shek. XX, zgjedhje/rizgjedhje;

**Kandidatët/ja për Bashkëpunëtor të lartë shkencor duhet t'i plotësojë këto kushte:**

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare.

**Dokumentacioni i nevojshëm**

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk është nën hetime,
- CV së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të,
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri", dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore. Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Kërkesat e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, , Rr., Eqrem Çabej - 10000 Prishtinë.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

**Datum, 05.04.2024**

Na osnovu članaka 30, 31, 33 i 35 Zakona br. 04/L-135 O Naučno-istraživačkoj Djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013); Član 8 Zakon o Radu Br. 03/L-212; članovi 29, 30, 31, 32, 33 i 34 Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini; i članovi 3, 5, 9, 11, 12 i 13 Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, Institut za istoriju "Ali Hadri" u Prištini, objaviti:

## KONKURS

3. (1) Naučni saradnik za novo vreme - izbor/ reizbor;
4. (2) Naučni saradnik za XX vekove - izbor/ reizbor;

**Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik mora ispuniti sledeće uslove:**

- Da ima doktorat nauka,
- Imati najmanje tri (3) naučne radove objavljena u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti, najmanje dva (2) od njih moraju biti nakon poslednjih izbora,
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje,
- Da učestvuje sa referatima na najmanje dva (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna.

**Potrebna dokumentacija**

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu za završetak doktorskih studija,
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrdjuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj,
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.).

Izbor osoblja Instituta Istorija "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br . 04 / L - 135 za istraživačke- naucne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri" , Zakon o Radu, i Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama, Zahtev se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Zgrada Arhiva Kosova). (Zgrada Državne Agencije za Arhive Kosova), Ul. Eqrem Çabej - 10000 Prishtinë.

**Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania N.P.T "Ferplast" Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:**

DEBAT PUBLIK

**Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin për prodhimin e tubave te plastikes (PP, HDPE) në Babush i Ri, Ferizaj.**

**Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.05.2024 në ora 11:00 në në Sallën e Kuvendit Komunal në Ferizaj, do të organizohet debat publik nga Kompania N.P.T "Ferplast" Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për objektin për prodhimin e tubave te plastikes (PP, HDPE) në Babush i Ri, Ferizaj.**

**Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM**

https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=5KMjjru9Lpykxzy8PKg2oGNyoI1o39.1

**Meeting Room: 953 525 7790**
**password: cWfFa6**

**Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë N.P.T "Ferplast" Ferizaj, për objektin për prodhimin e tubave te plastikes (PP, HDPE) në Babush i Ri, Ferizaj.**

**https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur**

**me projektin vnm.komente@rks-gov.net**

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**





RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË





## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Atdhe Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Leonard Nrecaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gresa Grajqevci shpall të pavlefshme ID-Kartelën e Kolegjit AAB Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

TREPÇA

Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 04.04.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

## Shpallje Publike
## T-24-4

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000
Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

**Shpallja Publike**

**Qëllimi i ofertës:**
- Dhënie me qera e hapësirave të objekteve në Njësinë Biznisore Metalurgjia e Zinkut.
- Sipërfaqa dhe çmimi fillestar

1. **Njësia Biznisore Metalurgjia e Zinkut**

Njësia Biznisore Metulurgjia e Zinkut

| Nr | Emri i Objektit | Siperfaqja e mbuluar (m2) | Çmimi neto (€) | TVSH (€) | Çmimi me TVSH (€) | Totali i Qerasë (€) | Siperfaqja e pambuluar (m2) | Çmimi neto (€) | TVSH (€) | Çmimi me TVSH (€) | Totali i qerasë (€) | Gjithsejt qeraja (€) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Depoja e Koncentratit të Zinkut | 3,249.00 | 0.80 | 0.14 | **0.94** | **3,054.06** | 830.00 | 0.50 | 0.09 | **0.59** | **489.70** | **3,543.76** |
| 2 | Menza e punëtorëve - Restauranti | 525.00 | 0.50 | 0.09 | **0.59** | **309.75** | | | | | | |
| 3 | Magazina e Makinerisë ( Depo përciellese e puntorisë) | 80.00 | 1.00 | 0.18 | **1.18** | **94.40** | | | | | | |
| 4 | Puntoria e makinerisë | 1,728.00 | 1.00 | 0.18 | **1.18** | **2,039.04** | | | | | | |

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes: 04.04.2024
Sqarimi: deri me 20.04.2024
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 20.04.2024
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Origjinali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 20.04.2024 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:
1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

***Shënime shtesë:***

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.
**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.
**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për $m^2$ duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.
**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.
**Operatorët ekonomik**: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

### Aneksi 1 OFERTA

| | |
|---|---|
| **Emri i OE:** | |
| **Loti** | |
| **Kodi (T)** | |

Llogaritja e vlerës së qerasë

| | | |
|---|---|---|
| a | Siperfaqa e mbuluar $m^2$ | |
| b | Çmimi për metër katrorë (€) | |
| c = b*18% | Çmimi për metër katrorë me TVSH (€) | |
| D=a*c | Vlera e qerasë për siperfaqen e mbuluar (€) | |
| e | Siperfaqa e pa mbuluar $m^2$ | |
| f | Çmimi për metër katrorë (€) | |
| g = f*18% | Çmimi për metër katrorë me TVSH (€) | |
| H=e*g | Vlera e qerasë për siperfaqen e pa mbuluar (€) | |
| I=D+H | Gjithsejt qeraja (€) | |

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

| | |
|---|---|
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | |
| **Vula:** | |

### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhëne me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.
Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.
Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

| | |
|---|---|
| **Emri i OE:** | |
| **Adresa e plotë:** | |
| **I përfaqësuar nga:** | |
| **Emri:** | |
| **Pozita:** | |
| **E-mail:** | |
| **Tel:** | |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | |
| **Vula:** | |

### Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 20.04.2024 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

### Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,
**Trepça** Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

**DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS**

Oferta duhet të jepet për $m^2$ dhe llogaritja përfundimtare në faturim


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES
95 g


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
NGA QUMËSHTI I FERMAVE TONA
VIDAS
DHALLË
NGA QUMËSHTI I FERMAVE TONA


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L